



HOXHALLARËT TANË,
ZOTËRINJTË TANË...



MA VËRTETUAT MENDIMI TIM,
QË KISHA PËR JU ATEISTËT!



LETËR INTERESANTE
NGA ARKITEKT SINANI

UDHA ISLAME

Viti 18 - Nr. 8 (210), Gusht, 2020

www.myftinia-shkoder.org

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative



MYFTINIASHKODER1990

"NËSE NUK E NDIHMONI
(TË DËRQUARIN),
TASHMË ATË E KA NDIHMUAR ALL-LLAHU..."

(Kur'ani, ET-Teube: 40)



1 muharrem 1442

20 gusht 2020



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Referatin tim të kësaj konference, do ta nis me lutjen e dijetarit të shquar shkodran, Hafiz Ali Kraja (1900-1973), botuar në librin e tij: “A duhet feja, a e pengon bashkimin kombëtar”, në të cilin shkruan: “I lutem të Madhit Perëndi që ta ruajë popullin shqiptar prej afetarizmit, që është një humnerë e rrezikshme për komb e atdhe! Amin.”¹

Duke lexuar me vëmendje në ecejaket e historisë sonë kombëtare, mendoj se kjo është një ndër lutjet më të rëndësishme, me të cilat duhet të ishin pajisur shqiptarët në të shkuarën e tyre, e sidomos në të sotmen, për të shpëtuar nga “humnerat e rrezikshme”, në të cilat shpesh kanë rënë duke dëshmuar momente aspak të këndshme, shpesh edhe tragjike, sidomos në 100 vitet e fundit të kësaj historie.

Gjatë shekujve, kontributi i imamëve dhe hoxhallarëve të shquar të Shkodrës dhe të mbarë Shqipërisë në drejtim të edukimit të brezave me besimin në Një Zot të Vetëm, me dije të gjithanshme, me përkushtim në jetë, me harmoni dhe tolerancë ndërfetare dhe vullnetin për të shërbyer për të mirën e atdheut të përbashkët, ka qenë jetik dhe me shumë vlerë.

Shfletimi i dokumenteve të botuara dhe të pabotuara, i dorëshkrimeve të vjetra dhe gjurmëve arkivore të lëna prej tyre na bën të besojmë dhe të themi me gojën plot se kontributi i hoxhallarëve tanë të ditur, qëndron në themelet e formimit të një shoqërie shqiptare të qytetëruar, të ditur dhe thellësisht besimtare.

Më lejoni që këtë referat ta zhvilloj nëpërmjet shembujve konkretë nga jeta dhe vepra e zotërinjve tanë, Hoxhallarëve të nderuar të Shkodrës.

1. Hafiz Ali Kraja, “A duhet feja, a e pengon bashkimin kombëtar”, ribotim, Tiranë, 2010, f. 9.

HOXHALLARËT TANË, ZOTËRINJTË TANË...

Gjatë shekujve, kontributi i imamëve dhe hoxhallarëve të shquar të Shkodrës dhe të mbarë Shqipërisë në drejtim të edukimit të brezave me besimin në Një Zot të Vetëm, me dije të gjithanshme, me përkushtim në jetë, me harmoni dhe tolerancë ndërfetare dhe vullnetin për të shërbyer për të mirën e atdheut të përbashkët, ka qenë jetik dhe me shumë vlerë.

Në vitin 1869, dijetari i shquar shkodran Daut Boriçizade, në librin e tij: “Abetare shqip”, shkruante se: “Shqiptari me mënyrën e shkronjave që kam kallzue në alfabetin shqip, mbrenda pak kohe mundet me shkruë gjuhën e vet”!²

Në vitin 1875 ai shkroi një tjetër: “Abetare e gjuhës shqipe me shkronja arabe”³. Studiuesit e abetareve shqipe, na bëjnë me dije se: “Daut Boriçi hyri në rolin e korifeut si didakt, si tekstolog dhe si organizator i arsimit popullor. Ai zuri në Veri këndin e trinomit që kishin plotësuar më parë Naumi në Jug dhe Kristoforidhi në kërthizë të Shqipërisë”.⁴

Në abetaren e tij të vitit 1869, për të cilën kam kontribuar personalisht në transkriptimin e disa fjalive, në shërbim të punës së dy studiuesve të saj, Shefik Osmani dhe Njazi Kazazi, Daut Boriçi jep disa këshilla me vlerë, në formën e mesazheve, si: “Mos rri pa punë, Shko n’shkollë, Mos prito, Ndigjo këshillat e mira, Kur t’flasësh, mendo; Mos rrej etj”⁵, sikurse porositi: “në mënyrë urdhërore: Xen me shkruë shqip”!⁶

Gjatë hulumtimeve, kam gjetur të shkruar me dorën e këtij njeriu të ditur edhe urtësi të shumta, që vlejën në jetën e shqiptarëve, si: “Shkrimi ngelet në libër, ndërsa autori shkrihet në dhë”, “Mëso o bir, se injoranca është turp. Atë s’e pranon veçse gomari”, “Thotë Resulull-llahi (s.a.v.s): Ai që vdes në rrugën e kërkimit të dijes, vdes shehid”⁷ etj.

Ky njeri i ditur, shembullin e tij të modestisë e dëshmon edhe në shënimet personale në librat e bibliotekës së tij, në të cilët kam gjetur edhe këtë shënim: “U rreshtua në rrjetin e posedimeve të

2. Shefik Osmani, Njazi Kazazi, “Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike”, Tiranë, 2000, f. 85.

3. Palok Lulash Daka, Tomor Osmani, Maks Gjina, “Bibliografi për historinë e alfabetit të gjuhës shqipe 1844-2008”, Tiranë, 2008, f. 9.

4. Shefik Osmani, Njazi Kazazi, “Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike”, Tiranë, 2000, f. 85.

5. Po aty, f. 92.

6. Po aty, f. 92.

7. Nuk e kam verifikuar.

mia, ndërsa unë jam i varfëri për të Vetmin, shkodrani, Boriçizade Daudi, i biri i Haxhi Mustafasë. I faltë të dy! Viti 260 h.” Vula.

Akoma sot, nuk dijmë se ndonjë shkollë a institucion arsimor në Shkodër, a përtej saj, të ketë emrin e nderuar të këtij dijetari dhe edukatori të nderuar, gjurmët e të cilit na bëjnë të ndjehemi edhe ne krenarë.

Rrugën e Daut Boriçit, në shkrimin e shqipes me shkronja arabe, në kohën kur ato ishin shkronjat me të cilat shkruhej gjuha e perandorisë më të fuqishme të botës, e kanë ndjekur edhe hoxhallarë të tjerë të nderuar të Shkodrës dhe përtej saj.

**S H F L E T I M I
i dokumenteve të botuara
dhe të pabotuara,
i dorëshkrimeve të vjetra
dhe gjurmëve arkivore
të lëna prej tyre na bën të
besojmë dhe të themi me
gojën plot se kontributi
i hoxhallarëve tanë të
ditur, qëndron në themelet
e formimit të një shoqërie
shqiptare të qytetëruar,
të ditur dhe thellësisht
besimtare.**

Në mesin e tyre dua të përmend Hafiz Jusuf Këlmendin (1876-1943), që la pas një libërth me “Ilahina shqip”, në brendësinë e të cilave shpjegohet se janë: “Rreshtue prej Haxhi Hafiz Jusuf Këlmendit, Imami xhamis Perashit poshtëm, n’ Shkodër”.

32 faqe, pa vit e vend botimi. Ajo përbëhet nga pesë ilahi në gjuhën shqipe me shkrim arab dhe përmban 343 vargje, të ndara në 171 strofa dhe një varg.

Në disa prej ilahive të tij, ai porositi për pastërti nga gabimet duke nxitur

moralin e pastër islam: “Tâ- Tahir banu ej rob - pej gjynahesh po shpëton / Ke me dék me hí në grôp - zban aty dobi pendim”⁸. Ai lutet për shpëtimin tonë nga krejt armiqët, duke thënë: “Ja rabbi mi ne ban rahmet - për hurmet alejhi selamit / Me na dhanun selamete - bytyn ne ehli islamit / Un i mjeri nji garîb⁹ - emni im Haxhi Jusuf / Anmiq’ tòn bani rezîl¹⁰ - gjithmôn leni n’teesuf”¹¹.

Kontributi i hoxhallarëve tanë në ndërtim të një shoqërie plot virtyte besimi, dije dhe thellimi në shkencat e ndryshme janë të shumtë. Mjafton që kur përmenden hoxhallarët e Shkodrës, mendja të shkon menjëherë te bibliotekat e shumta me libra të panumërt, në shkenca të ndryshme e dije pafund.

Kur flitet për Medresenë e Pazarit në Shkodër, thuhet se ajo ishte: “një qendër e vjetër ku mësohej feja, kultura islame dhe atdhedashuria... Kjo medrese ka pasur një bibliotekë të pasur me vepra fetare, letrare dhe shkencore...”¹²

Studiuesit shkruajnë: “Dihet se ktu në Shkodër ka ma se 25.000 (njizet e pes mi volume vetëm në gjuhët klasike orientale)”¹³.

Kujtojmë Jusuf Tabakun (1797-1904), biblioteka e të cilit thuhet se “kishte rreth 2000 libra të inventarizuar e të vulosur me etiketë përkatëse”¹⁴. Një pjesë e mirë e këtyre librave dëshmohej të jenë shkruar me dorë, të kopjuar nga origjinalet. Për këtë kam gjetur disa shënime me shkrimin e dorës së tij, ku shënohet: “Posedues me anë të shkrimit, Jusufi Siddik, Myderrizi dhe Myftiu i qytetit Shkodër. E faltë (Zoti)”. Ky shënim shoqërohet edhe me vulën e tij personale.

8. Ilahija I, vargjet nr. 31-32.

9. GARËB-I m. mb. vjet. Shkodër, Elbasan: i vorfën, dorëhollë, që jeton me vështirësi e nuk shtrinë dorën. ... Në tur. garip<ar. garîb غريب “i huej që jeton në mërgim, i panjeri, i vorfën, i ngratë, i çuditshëm”...Etj. – Tahir N. Dizdari, “Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe”, Tiranë 2005, f. 291-292.

10. REZIL-E mb. ndf. dhe em. I marruem, i shnerzuem, fytyrëplasë, faqezi, i poshtëm, rus-paq, i dalun bojet, remall; it. Mascalzone, screditato, disonesto. U shamatuën e u bânë rezil! ... Pvb. “Vjedhja e rezilit ka më lezet se rixhaja e nikoqirit”. Jugë. “Aksham vezir, sabah rezil” (për kumarxhiun)- Shkodër. Etj. – Tahir N. Dizdari, “Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe”, Tiranë 2005, f. 840.

11. Ilahija I, vargjet nr. 71-74.

12. Ali M. Basha, “Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri”, Tiranë, 2011, f. 126.

13. Xhafer Shkodra: “Bibliotekat t’ona”, në revistën “Kultura islame”, viti III, tetor 1941, nr.2, f.63.

14. Faik Luli, Islam Dizdari, Nexhmi Bushati, “Në kujtim të brezave”, Shkodër, 1997, f. 21.



Në njërin prej këtyre librave, të kopjuar me shkrimin e dorës së Hirësisë së Tij, shkruhet: “E shkroi Jusufi Siddik, Myderrizi dhe Myftiu i Shkodrës. Allahu e faltë atë dhe prindët e tij. 26 Shevval 1286, nata e shtunë, pas akshamit”.

Fatkeqësisht, gjaku mesjetar në venat e njerëzve-hije, bëri që në fundvitin 1998, shtëpia ku këta libra pushonin, pas lëngatës së gjatë nën hirtësitë e sistemit komunist, të digjet e tëra, duke u djegur kështu një ndër thesaret më të çmuar të kulturës dhe të diturive të lashta në Shkodër, biblioteka e Jusuf ef. Tabakut...

Nuk ka dyshim se kush ka lexuar sadopak për hoxhallarët e Shkodrës, ka vërtetuar lidhjen e tyre pas librit dhe dijes, saqë në shënimet e Hasan ef. Podgoricës, prej të cilit ka marrë ixhazet Hafiz Halid Bushati, që ishte muxhizi i Hafiz Jusuf Këlmendit, kam gjetur këtë shënim anësor, në gjuhën arabe: I tha Es-Sejjid Esh-Sherif El-Xherxhani, Imam Teftazanit, në vargje:

“Mos e ndalo librin që hua të kërkohet,
Kopracia për njeriun turp është!

A s’e ke dëgjuar hadithin që transmetohet,
Shpërblimi i kopracisë tek All-llahu, zjarr është!?”

Edhe Imam Teftazani ia ktheu në vargje:

“O ti kërkues i librave, lermë,
Se huazimi i të dashurit, turp është!
I dashuri im në këtë botë, libri është,
A ke parë që i dashuri hua jepet!?”

Kujtojmë Hafiz Ibrahim Repishtin (1882-1943), për bibliotekën e të cilit shkruhet se: “ka numëruar rreth 2000 vëllime ku ka pasur kopje unikale

librash...”¹⁵.

“Le të kujtojmë se ai i takonte breznisë së luftës për mbrojtjen e Shkodrës (1912-13) dhe se ishte pjesë e kompaktësisë shkodrane të atyne viteve. (Ai ka kaluar shtatë muej në llogoret e frontit të Shtojt, dhe familja Repishti ka furnizue me ushqim e armatim 17 vullnetarë të kompanisë që ai komandonte gjatë të gjithë luftës). Ma vonë, me 1916, kur Austro-Hungaria filloi keqtrajtimin e qytetarëve shkodranë, ai ka marrë pjesë në demonstratat anti-austriake, dhe ashtë burgosë me një grup qytetarësh. Ka luejtë një rol aktiv në mobilizimin dhe organizimin e Luftës se Koplikut (1920), për gjashtë muej. Në ato vite, ka ndihmë aktivisht Komitetin për Mbrojtjen e Kosovës (Hoxha Kadriu dhe shokët kanë ba disa nga mbledhjet e Komitetit në shtëpinë e babës), ka marrë pjesë aktive në politikën e forcimit të vendit, dhe në dhjetor 1923 asht zgjedhë deputet i Shkodrës (grupi i Opozitës kundër Ahmet Zogut).”¹⁶

Ai ishte nxënës i devotshëm i dijetarit të shquar Hafiz Halid Bushati (?-27 dhjetor 1916), prej nxënësve të cilit u diplomuan edhe dijetarë që më pas dhanë një kontribut të vyer në organizimin e shqiptarëve në mërgatë, si Hafiz Sulejman Gavoçi (20.1.1883-1958), që emigroi në Damask të Sirisë.

Kur flasim për mërgatën, nuk mund të lëmë pa përmendur rolin e madh të Kryemyftiut të shqiptarëve në botën e lirë, Salih ef. Myftija (1891-1978), gjurmët e të cilit janë të arkivuara edhe në gazetën e famshme amerikane

15. Hamdi Bushati, “Shkodra dhe motet”, vëllimi II, f. 234-236.

16. Sami Repishti, “Nga kujtimet e prof. Sami Repishti për të atin Hafiz Ibrahim Repishti”, në gazetën “Udha Islame”, viti X, nr. 1 (107), janar, 2012, f. 12-13.

Kujtojmë hoxhallarët e shumtë që ranë a u plagosën në betejat e tyre në luftë për mbrojtjen e Shkodrës dhe trojeve shqiptare nga serbo-malazezët, si rasti i dy hoxhallarëve të nderuar, H. Halil Gavoçi dhe H. Sulejman Gavoçi, babë e bir, të cilët “në vitin 1913, kur Shkodra u rrethua nga forcat serbe e malazeze... rrokën armët e dolën vullnetarë për mbrojtjen e qytetit nën komandën e Hasan Riza Pashës”

“The New York Times”, që “në numrin e 13 nëntorit 1972, të ditës së hënë, njofton se në rrugën Albermarle 1325, në zonën Flatbush të Brooklyn-it u ngrit xhamia e re e komunitetit Mysliman të Shqiptarëve të Amerikës me inisiativën e Kryemyftisë Salih Efendi Myftija, mbi 80 vjeç”¹⁷

Kujtojmë poliglotin e shquar **Hafiz Abaz Golemi** (1870-1925), i cili “që në vitin 1895 emërohet mësues i persishtes dhe i besimit në shkollën qytetëse”¹⁸. Studiuesit e jetës së tij dëshmojnë se ai: “Përveç persishtes zotëronte edhe arabishten, turqishten, frëngjishten, italishten e serbokroatishten”.¹⁹ Nuk duhet të harrojmë se: “Në vitin 1913 Komisioni Arsimor i Bashkisë, i kryesuar nga Xhemal Naipi, kadi i Shkodrës në atë kohë, hapi tri shkolla shtetërore: Shkolla Popullore me drejtor Gaspër Mikeli, e Rusit me drejtor Molla Medo Sukniqi dhe e Parrucës me drejtor Haxhi Hafiz Abaz Golemi”.²⁰

Nëse në vitin 1913, lënda e besimit fetar ishte pjesë programit në shkollat shtetërore shqiptare, sot në vitin 2012, kur shumë vende të Evropës e kanë aplikuar lëndën e edukatës fetare në shkollat e tyre, paradoksalisht në Shqipëri ky fakt vazhdon të shihet me utopi...

Në raportet e inspektorit të arsimit

17. Faik Luli, Islam Dizdari, Nexhmi Bushati, “Në kujtim të brezave”, Shkodër, 1997, f. 391-392.

18. Po aty, f. 206.

19. Po aty, f. 206.

20. Po aty, f. 208.

Shkodër drejtuar Ministrisë së Arsimit, më 6.2.1925, në lidhje me personalitetin e H. Abaz Golemi shkruhet se: “në kohën e 12 vjetëve mund të vërtetojmë se ai përherë qe drejtori i shkollës së Parrucës dhe përherë gëzoi dhe gëzon gjithnjë një famë të mirë në popull, sa që fëmijët prej të tana lagjeve e marrin mbrapa dhe mund të themi se shkolla e Parrucës asht sot një fryt i tij”²¹

Megjithatë, Hafiz Abaz Golemi ishte njeri modest, i frikësohej Zotit të botëve dhe këtë e dëshmonte në shënimet personale mbi faqet e brendshme të librave të tij, ku kam gjetur edhe këto shënime: “Prej librave të të varfërit, të përulurit, Haxhi Hafiz Abaz, i biri i Haxhi Aliut. I faltë të dy, Falësi, Krijues. Amin!”. Shumë interesante është edhe përmbajtja e vullës së Hirësisë së Tij, ku shkruhet: “Më i dobëti i njerëzve, robi, Hafiz Abaz. 1307”.

Kujtojmë hoxhallarët e shumtë që ranë a u plagosën në betejat e tyre në luftë për mbrojtjen e Shkodrës dhe trojeve shqiptare nga serbo-malazezët, si rasti i dy hoxhallarëve të nderuar, H. Halil Gavoçi dhe H. Sulejman Gavoçi, babë e bir, të cilët “në vitin 1913, kur Shkodra u rrethua nga forcat serbe e malazeze... rrokën armët e dolën vullnetarë për mbrojtjen e qytetit nën komandën e Hasan Riza Pashës”²²

Poashtu Sheh Ali Kruja (1884-1976), që doli dy herë në frontet për mbrojtjen e Shkodrës nga serbo-malazezët. Në betejën e tij të dytë, në vitin 1920, në frontin e Koplikut, “nga plaga e rëndë humbi syrin e majtë”.²³

Kujtojmë shumë dijetarë, hoxhallarë të nderuar, që me veprën e tyre i bëjnë nder këtij kombi dhe na bëjnë të ndjehemi krenar për ta dhe gjurmët e tyre të dritshme e fisnike. Kush nuk i njeh në botën arabe dhe islame dijetarët shkodoranë Muhammed Nasiruddin El-Albani, Shejkh Shuajb El-Arnaut dhe Shejkh Vehbi Sulejman Gavoçi, librat e të cilëve kanë mbushur bibliotekat islame bashkëkohore.

Fatkeqësisht, dekadat e kaluara nën regjimin ateist të imponuar nga Partia e Punës e Shqipërisë, bënë që shqiptarët të ndahen nga ky shpirt dhe kjo frymë, madje edhe të dëshmoreshin publikisht plot krenari dhe mburrje kundër saj.

Edhe këtu, nuk mund të harrojmë thirrjen e ez’heristit të ditur Hafiz Ali Kruja, që në vitin 1934 shkruante: “...

21. Po aty, fq 213-214.

22. Po aty, f. 650.

23. Po aty, f. 462.

lus vllaznit musliman të mos gënjejen me fjalët e bukra t’asaj pjesë pseudo-intelektualsh, pse qellimi i këtyne është me dobsue konvikcionin dogmatik në shpirtin e fetarve, e nuk janë fjalë të bazueme... mbi shkencë e filosof”²⁴ duke sinjalizuar errësirën komuniste dhe një frymë faraoneske që po vërshonte drejt Shqipërisë për ta rrënuar e poshtëruar para mbarë botës...

Nuk duhet të harrojmë shkrimet e panumërta në gazetën “Jeta e re”, e simotrat e saj, ku shkruhej se: “Në vendin tonë rinia dhe mbarë populli, të edukuar nga partia me qartësi politike dhe ideologjike, u çuan në këmbë, po fshijnë nga jeta dhe ndërgjegja mbeturinat e botës së vjetër dhe rreziku i fesë dhe paragjykimeve të saj është pakësuar...”²⁵

Nuk duhet harruar zëri i kobshëm, që shëmtueshëm, thërriste se: “Për vazhdimin e luftës kundër ideologjisë fetare, shumë i vlefshëm do të ishte krijimi i një muzeu ateisto-shkencor në qytetin tonë. Hapja e një muzeu të tillë, për të cilin janë krijuar mundësitë, do t’i vlente jo vetëm qytetit dhe rrethit tonë, por edhe rretheve të tjera”.²⁶

Nuk duhet harruar dhuna dhe persekutimi ndaj hoxhallarëve tanë të nderuar, të cilët qëndruan me burrëri dhe plot besim para tundimeve femohuese. Janë të shumtë në numër, në shembuj konkretë e vuajtje.

Nuk duhet harruar se: “Me akuzën “dijeni për Lëvizjen e Postribës”, ishte arrestue edhe i forti Hafiz Musa Dërguti, për të cilin do t’u fliste, se kur kishte qenë në një dhomë paraburgimi me Gjon Serreqin dhe i lidhun dorë për dorë me te, ishin pasë çue e ulë sëbashku si të kishin qenë një trup i vetëm, sa herë që gjatë ditës e natës t’i vinte vakti hafizit për me iu falë Zotit, si musliman e si hoxhë që ishte”²⁷, ose: [Po ashtu i mbështjellë nofullash me shami për mungesë mjekre edhe plaku tjetër Hafiz Musa Dërguti, që do kohë ma parë ia kishte la në gjak fytyrën një polici, kur ai i kishte pasë derdhë ujtë e “abdesit” aty te truma, e që kur kishte kenë në Sigurim, i kishte pasë thanë një shoku të dhomës: “Më

24. Hafiz Ali Kruja, “A duhet feja- A e pengon bashkimin kombtar?”, Shkodër, 1934, f. VI.

25. Dr. Zyhd Çoba, “Për t’i zhgulur me rrënjë, duhen njohur me rrënjë”, në gazetën “Jeta e re”, viti I, nr. 75, e shtunë, 30 dhjetor 1967, f. 3.

26. Luigj Frania, “Përdorimi i emrave me origjinë fetare është i dëmshëm”, në gazetën “Jeta e re”, viti II, nr. 59 (134), e mërkure, 24 korrik 1968, f. 3.

27. Ahmet Bushati, “Në gjurmët e një ditari”, Shkodër, 2007, f. 172.

kërkojnë me folë për priftën, dojnë me na përça, e nesër me thanë se u pushkatuen priftët me dëshmitë e hoxhallarëve. U kam thanë bani çka të doni, se atë punë s’e baj kurr”].²⁸

“Në vitet 1943-1944, kur idetë komuniste u propaganduan në mënyrë më të organizuar, në qytetin e Shkodrës Hafiz Musai ishte ndër kundërshtarët më të vendosur. Ai në tubime të ndryshme, spontane apo dhe në xhami fliste për rrezikun e madh që do të sillte triumfi i komunizmit në Shqipëri”.²⁹

Kujtoj nga fëmijëria, se kur gjyshi im, Haki Hoxha (Sytari), fliste për mjerimin që kishte sjellë komunizmi për vendin dhe shqiptarët, kujtonte “mikun e shpís”, Hafiz Musa Dërgutin, që në një prej ndenjave u kishte thënë se: “Enver Hoxha asht qafiri biddin”!³⁰”.

Nuk duhet harruar dhimbja e hoxhallarëve të mëdhenj shqiptarë në mërgatë si Hoxha i jonë Vehbi S. Gavoçi, i cili dëshmon se: “Ndër artikujt e parë që kam shkruar është edhe “Asal- xhenneh” - (Shkopi i xhenetit), ku kam shkruar për Shqipërinë, vuajtjet që keni pësuar ju, vëllezërit e mi, pas vitit 1944.

I pari artikull i imi ka qenë për ju, për vendin tim. Pastaj, shumë kam shkruar për Shqipërinë nëpër revista, gazeta apo libra dhe jam munduar që të mos e harroj vendin tim, që më ka bërë nder të madh. Këtë e kam bërë që t’ia kthej atë nder të madh vendit tim me plot respekt.”³¹

Është e pamundur të mos qëndrojmë me respekt para kujtimit të hoxhallarëve, shehlerëve, medresistëve e aktivistëve islamë shqiptarë që u sprovuan në burgjet komuniste a në lirinë e tyre intelektuale, si:

Hafiz Ali Korça (burgosur në vitin 1945),

Hafiz Ibrahim Dalliu (burgosur në vitin 1946),

Hafiz Ismet Dibra, ish- drejtor i Medresesë së Përgjithshme, Tiranë (burgosur në vitin 1946),

Hafiz Sabri Koçi (burgosur në vitin 1966),

Dede Reshat Bardhi (internuar 15 vjet),

Haki Sharofi, ish-kryeredaktor i revistës “Zani i Naltë” (burgosur në vitin 1946),

28. Po aty, f. 428.

29. Faik Luli, Islam Dizdari, Nexhmi Bushati, “Në kujtim të brezave”, Shkodër, 1997, f. 158.

30. D.m.th. femohues.

31. Muhamed Sytari, “Vehbi Sulejman Gavoçi-dijetar prej dijetarëve të ymmetit”, Prishtinë, 2005, f. 22.

H. Vehbi S. Gavoçi:
“Ndër artikujt e parë që kam shkruar është edhe “Asal-xhenneh”, ku kam shkruar për Shqipërinë, vuajtjet që keni pësuar ju, vëllezërit e mi, pas vitit 1944.
I pari artikull i imi ka qenë për ju, për vendin tim. Pastaj, shumë kam shkruar për Shqipërinë nëpër revista, gazeta apo libra dhe jam munduar që të mos e harroj vendin tim, që më ka bërë nder të madh. Këtë e kam bërë që t’ia kthej atë nder të madh vendit tim me plot respekt.”

Jonuz Bulaj (burgosur në vitin 1946),
Vexhi Buharaja (burgosur në vitin 1946),

Ismail Muçej (burgosur në periudhën 6 shtator 1952 - 24 prill 1963),

Hasan Tahsini (burgosur në vitin 1947),

Baba Bedriu i Brerimës (ekzekutuar në vitin 1947),

Baba Hajro Progonati (ekzekutuar në vitin 1947),

Hafiz Mustafa Varoshi, ish-myfti i Durrësit (burgosur në vitin 1945),

Hafiz Sherif Lëngu, ish-kryetar i Këshillit të Naltë të Sheriatit (burgosur në vitin 1945),

Hafiz Esat Myftia, ish-kryetar i Komitetit Mysliman Shqiptar (burgosur në vitin 1946),

Hafiz Musa Dërguti (burgosur në vitin 1946),

Hafiz Ali Kraja (burgosur në vitin 1945),

Imam Liman Shabani (vdekur në burg më 1945),

Imam Met Troci (vdekur në burg më 1947),

Sheh Ibrahim Karabunara (vdekur në burg më 1947),

Sheh Myslim Luma (vdekur në burg më 1953),

Baba Myrteza Kruja (vdekur në burg më 1945),

Imam Ahmet Hyseni (vdekur në burg më 1945),

Dervish Mehmet Verleni (vdekur në burg më 1947),

Xhemal Naipi (me vendim nr. 218, dt. 23.6.1947 të Gjykatës Ushtarake Shkodër është dënuar ... me privim lirie për jetë, me punë të detyruar, humbjen e të drejtave civile e politike...- vdiq në burgun famëkeq të Burrelit në vitin 1955 në moshën 77 vjeçare, pa pasur familjarët dijeni as për varrin e tij),

Hafiz Sheuqet Boriçi (i vetëizoluar në shtëpi deri në vdekje).

Hafiz Sabri Bushati (i vetëizoluar në shtëpi në vitin 1967, në moshën 77 vjeçare deri në vdekje),

Molla Alush Zaganjori (i vetëizoluar në shtëpi deri në vdekje),

Shejkh Hafiz Vehbi Sulejman Gavoçi (u ndalua disa herë nga regjimi komunist për të vizituar vendlindjen e tij, Shkodër), etj.³²

Në përfundim të këtij materiali, unë jam i bindur se ajo çfarë kam paraqitur para jush është më e pakta e mundshme, për të vërtetuar e dëshmuar madhëshinë e hoxhallarëve tanë të nderuar, që ia falën jetën misionit të shenjtë të edukimit të njerëzve me besimin e patundur në Zotin Një, si dhe u bënë shembulli më i mirë i praktikimit të këtij besimi në jetë, me dije, durim, përkushtim, harmoni e tolerancë.


Në kujtim dhe vlerësim të veprës dhe shembullit të tyre, Kryesia e Komitetit Mysliman të Shqipërisë, ka botuar para pak kohësh vëllimin e parë të enciklopedisë: “100 personalitete shqiptare të kulturës islame”.

Jam i bindur se sa më shumë që lexojmë dhe hulumtojmë rreth gjurmëve të hoxhallarëve tanë të nderuar, aq më tepër bindemi për madhëshinë e misionit të tyre dhe amanetin e shenjtë që lanë pas. Ai amanet nuk mund të mbetet vetmitar në krahët e kohës... Është amanet i pastër që e trashëgojnë sërish zemra të pastra e të përkushtuara për t’i shërbyer misionit më të lashtë e më të shenjtë të njerëzimit...

Rahmete mbi shpirtat e hoxhallarëve të Shkodrës, të mbarë kombit shqiptar!

(ribotim)

32. Lista me emrat e hoxhallarëve dhe shehlerëve të persekuatuar nga sistemi komunist është marrë nga autorët Nasuf Dizdari e Faik Kasollija, në gazetën “Drita Islame”, viti I i botimit, e premtë, 6.3.1992, nr.5.



Sheikh Muhamed El-Gazali
(1917 - 1996)

MA VËRTETUAT MENDIMI TIM, QË KISHA PËR JU ATEISTËT!

- Ne jetojmë në këtë botë dhe e prekim ekzistencën e saj, kështu që nuk mund ta mohojmë atë!

- Kush ta ka kërkuar të mohosh ekzistencën e botës?!

Ne, kur hipim në makinë, anije apo aeroplan, që na mbartin në një rrugë të frikshme, pyetja jonë nuk është rreth ekzistencës së mjetit, por ajo është: A lëviz vetvetiu? Apo, atë e drejton shoferi syhapur!!

Pastaj, sidoqoftë, unë i kthehem pyetjes tënde të parë, për të të thënë: Ajo është kundër teje, sepse unë dhe ti pranojmë ekzistencën e një ekzistuese, që nuk mund të mohohet; për të cilin ti pretendon se ai nuk ka të parë (paraprijës) për të në raport me materien (lëndën), ndërsa unë mendoj se Ai nuk ka të parë (paraprijës) për Të në raport me krijuesin e saj.

Nëse kërkon të tallesh me ekzistuesin që nuk ka të parë (paraprijës) përpara tij, atëherë tallu me veten tënde përpara se të tallesh me fetarët.

- Ti mendon se supozimi mendor është prezent tek të dy grupet?

- Unë po zgjatem me ty për të zbuluar boshllëkun dhe pretendimin, tek të cilët mbështetet ateizmi dhe kaq, ndërsa supozimi mendor, ai nuk është i njëjtë për besimtarët dhe mohuesit.

Unë dhe ti, e shohim kështjellën e ndërtuar. Unë e shoh, pas një vështrimi perfekt, se inxhinieri e ka ndërtuar, ndërsa ti mendon se dërrasat, hekuri, gurët dhe boja janë vendosur në vendin e tyre, e janë rregulluar për banorët e saj vetvetiu!

Dallimi mes dy vështrimeve tona ndaj gjërave është, se kur shohim satelitin

artificial që sillet në hapësirë, ti thua: Është lëshuar vetvetiu, pa mbikëqyrës dhe pa prodhues, ndërsa unë them: Jo, atë e ka lëshuar mendja mbikëqyrëse dhe ideuese.

Supozimi mendor nuk është i njëjtë; ai për sa më përket mua, është e vërteta pa të cilën nuk mund të bëhet; e për sa të përket ty, ai është e kota, në të cilën nuk ka dyshim për të. Mohuesit (jobesimtarët) e kohës sonë janë inteligjentë në fyerjet ndaj nesh, besimtarëve dhe akuzohena me çdo të metë, ndërkohë që veten e tyre e cilësojnë si të zgjuar, të përparuar dhe gjenialë.

Ne jetojmë në tokën e shtruar dhe nën qiellin e ndërtuar; zotërojmë mendje, me të cilën mundemi të hulumtojmë dhe të gjykojmë dhe me këtë mendje vështrojmë, nxjerrim përfundime, debatojmë, besojmë... dhe me këtë mendje refuzojmë imitimin e verbër, ashtu siç refuzojmë pretendimet boshe.

Nëse njerëzit tallen me të prapambeturit, adhuresit e shkuar dhe i kritikojmë njerëzit për mendimet e tyre të ngurta, atëherë nuk është ndonjë gjë, që të tallen gjithashtu me ata, të cilët e vdesin (mbysin) mendjen në emër të shkencës; të tillët, për fat të keq janë masa e ateistëve!

Por, ne myslimanët, e ndërtojmë besimin tonë në Allah mbi bazën e zgjuarsisë mendore, veprimeve të opinionëve dhe i nxjerrim përfundimet logjike për argumentet e ekzistencës së Lartë përmes lëvizjeve të mendjes njerëzore në të gjitha anët e universit.

Në një faqe të vetme nga një sure e vetme prej sureve të Kur'anit Famëlartë kam gjetur citim të detyrës së mendjes, ku merren tre pamje të njëpasnjëshme

në shkallët e ngritjes.

Kjo është sureja Ez-Zumer dhe në fillim të saj ty të shfaqet lartësimi i çështjes së ditorisë (shkencës) dhe mospërfilljes ndaj injorantëve: "Thuaj: A janë të barabartë ata, të cilët dinë dhe ata, të cilët nuk dinë? Me të vërtetë, përkujtojnë të zotët e mendjes!" - (Kur'ani, Ez-Zumer: 9)

Pastaj, të vjen pamja e dytë, për të sqaruar, se myslimani nuk është skllav i mendimit të ngurtë apo i një zakoni mbizotërues, por ai është njeri që peshon çfarë i ekspozohet përpara tij dhe zgjedh atë, që është më faktike dhe më e dëlirë: "Përgëzoji robërit (e Mi). Ata, të cilët dëgjojnë fjalën dhe pasojnë më të mirën e saj. Të tillët, janë ata, të cilët i ka udhëzuar Allahu dhe të tillët janë të zotët e mendjes". - (Kur'ani, Ez-Zumer: 17-18)

Më pas, për herë të tretë sillet përmendja e të zotëve të mendjes, në këtë kontekst, se ata janë njerëz të vështirimit në mbretërinë e Allahut, të cilët e studiojnë historinë e jetës në të gjitha anët e ndryshme të saj për të kaluar nga krijesat tek Krijuesi: "A nuk e shikon, se Allahu zbret shiun prej qiellit, e ai rrugëton burime-burime në tokë? Pastaj, përmes tij nxjerr bimësi me ngjyra të ndryshme; pastaj thahet dhe e shikon të zverdhur; pastaj atë e bën dushk! Me të vërtetë, në këtë ka përkujtim për të zotët e mendjes". - (Kur'ani, Ez-Zumer: 21)

Siç shihet nga këto tre pamje në këtë faqe të Shpalljes së Fundit, besimi është i shpëputur prej imitimit të verbër, vështirimit të mangët apo mendimit të dobët.

Ai e vë re shpikjen e Krijuesit tek bimët, lulet dhe frutat. Se, si nga balta me erë shpërthejnë ngjyra të ndritshme apo të zbehta, që shpërndahen nëpër gjethe dhe degë, të mbushura me shpirt dhe aromë. Pastaj, të gjitha këto i korrë, për të qenë rroba e ushqim për njerëzit dhe kafshët; pastaj kashta dhe kalbësitjet kthehen përsëri rishtazi bimë me bukuri të reja e shije, që valëvisin arat e fushat, kush e krijoi gjithë këtë?!

Shoku ynë, sikur të ishte i dehur e nuk di çfarë thotë, tha: Toka e ka bërë gjithë këtë!

- Toka i ka urdhëruar retë të lëshojnë shiun, diellin të rrezatojë dhe gjethet e pemëve të depozitojnë karbonin?!

- Kam për qëllim tërë natyrën, në tokë dhe në qiell!

- Pjata me oriz në dreqën apo darkën tënde, toka me qiellin dhe çfarë ka mes tyre kanë bashkëpunuar për të bërë çdo kokërr orizi? Atëherë, çfarë roli ka secili

element në këtë krijim?

Kush është përgjegjës i bërjes së mollës të ëmbël dhe të specit djegës? A është dheu i tokës apo shiu i qiellit?

- Nuk e di! E, çfarë vlere ka kjo njohje!

A nuk e di, se kjo ka nevojë për mendje drejtuese dhe vullnet që ndan llojet?

Atëherë, ku e sheh mendjen, e cila krijon dhe vullnetin, i cili shfaqet në tokën djerr apo në valët e rrezeve?

- Bota është krijuar vetvetiu dhe ka evoluar sipas praktikës së zhvillimit dhe evoluimit, e nuk e dimë origjinën dhe as hollësitë!

Le ta shpjegoj se çfarë do të thuash!

Thoni: Dikur në kohë të vjetra e në periudhën dhe epokën e hershme ka ekzistuar një grup elementesh të verbër, që silleshin në hapësirën e universit, pastaj me kalimin e kohës dhe përplasjet e shumta, erdhi shansi i vetëm, që nuk përsëritet më kurrë, dhe u krijua qeliza e gjallë në formën e saj fillestare, pastaj filloi të shumohet dhe të rritet, derisa arriti këtë që shohim!

Kjo është ajo injoranca, të cilin ju e keni quajtur shkencë dhe nuk jeni turpëruar prej hiperbolizimit të dynjasë me të! Veprime matematikore të komplikua thoni: Janë zgjidhur vetvetiu; gjallesa inteligjente dhe të mrekullueshme, pretendoni se ato kanë ardhur në jetë nga një shans i dhënë, që nuk përsëritet më kurrë! E gjitha kjo është arratisje prej besimit në Allahun e Madh!

Tha, me gjithë urrejtje, e të kishte Zot, sikur ju thoni, a do të ishte dynjaja e mbushur me gjithë këto tragjedi dhe dhimbje? Shohim pasurinë nëpër të cilën kënaqen të pasurit, vështirësitë që bllokojnë të mençurit, fëmijët që sëmuren e vdesin dhe invalidë që jetojnë në zymtësi, etj.

I thashë: Ma vërtetuat mendimi tim, që kisha për ju! Ateizmi juaj ka të bëjë me probleme psikologjike dhe shoqërore më shumë se sa ka të bëjë me çështje mendore të rëndësishme!

Që në kohë të vjetra kanë ekzistuar njerëz që besojnë dhe njerëz që mohojnë sipas asaj që i godet prej vështirësive dhe lehtësive: "Ka njerëz, që e besojnë Allahun me hezitime, nëse e godet e mira, qetësohen me të, e nëse e godet ndonjë sprovë, rikthehet në fytyrën e tij, humb dynjanë dhe ahiretin!" - (Kur'ani, El-Haxh: 11)

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja

LUANI, MBRETI I KAFSHËVE

Luani, kafshë e njohur grabitqare. Në arabisht ka mbi 500 emra, ku më të njohurit janë: Esed, Usame, Harth, Harithe, Hajdere, Seb', Kasvere (me këtë emër përmendet në Kur'an), Lejth apo Lejs, Hamza, e të tjerë. Emrat e shumtë tregojnë për vlerën dhe rëndësinë e tij.

Po ashtu, luani ka edhe shumë pseudonime, prej tyre mund të veçojmë: Ebul Ebtal, Ebu Hafs, Ebul Ahjaf, Ebu Zaferan, Ebul Abas, Ebul Harith etj.

Quhet "Mbreti i kafshëve" për shkak të fuqisë, trimërisë, guximit dhe sjelljeve të tij, prandaj edhe konsiderohet simbol i fuqisë dhe sovranitetit, trimërisë e guximit. Për këtë arsye, xhaxhai i Pejgamberit (a.s.), Hamza, i biri i Abdul Muttalibit është quajtur "Esedullah – Luani i Allahut".

Ekzistojnë disa lloje të luanëve. Luanesha mund të lind përnjëherë deri në pesë luan të vegjël, të cilët pasi lindin, nuk shohin, apo nuk i hapin sytë deri në ditën e shtatë, ndërsa në muajin e gjashtë, fillojnë të rrëmbejnë (gjuajnë) kafshë të tjera që të ushqehen me mishin e tyre.

Kanë thënë se luani e përballon urinë dhe etjen aq sa nuk mund ta përballojnë kafshët e tjera grabitqare. Prej cilësive të tij është se nuk e ha gjahun e kafshëve të tjera. Kur të ngopet me prenjë e vet, e lë dhe nuk kthehet më te ajo. Pas ushqimit, bën lëvizje trupore dhe nuk e pi ujin të cilin e ka lëpirë qeni. E kapërdinë ushqimin duke mos e bluar (përtypur) me dhëmbë. Ka pak pështymë, prandaj edhe kundërmon erë të keqe.

Përpos që është shumë i fuqishëm dhe guximtar, përkthehet gjithashtu edhe si frikacak. Frikësohet nga zëri i gjelit, nga zëri i enës kur bie në tokë dhe maçoku. E mundon (i jep siklet) shikimi i zjarrit të ndezur. Jeton gjatë dhe shenjë e pleqërisë së tij është rënia e dhëmbëve.

Sipas Ebu Hanifes, Shafiut, Ahmedit dhe xhumurit të dijetarëve, ndalohet ngrënia e mishit të luanit, bazuar në hadithin të cilin e transmeton Muslimi në "Sahihun" e tij, se Pejgamberi (a.s.) e ka ndaluar ngrënien e mishit të egërsirave dhe shpendëve grabitqar.

Imam Demiri në "Hajatul Hajvan el-Kubra"

Përktheu me disa shkurtesa:

H. Enes Koshi
Rebstein, Zvicër

Dallimi mes dy vështrimeve tona ndaj gjërave është, se kur shohim satelitin artificial që sillet në hapësirë, ti thua: Është lëshuar vetvetiu, pa mbikëqyrës dhe pa prodhues, ndërsa unë them: Jo, atë e ka lëshuar mendja mbikëqyrëse dhe ideuese.





Naim Driaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Jetojmë në një kohë shumë të vështirë ku hallet, problemet, stresin... etj, janë shtuar më shumë se asnjëherë. Njerëzit kanë stres për sëmundjen, borxhin, martesën, qiranë, shkollimin, fakultetin, shtëpinë, ilaçet, papunësinë. Dikush ka stres që nuk ka fëmijë, dikush ka stres që nuk i del rroga, etj.

Në këtë shkrim do të flasim për disa këshilla se si mund ta menaxhojmë apo largojmë stresin.

Një dijetarë ka thënë: “Koka e njeriut është sikur bahçeja (kopshti). Njeriu mbjell në të çfarë të dojë.

1. FRIKA NDAJ ZOTIT

Allahu i Madhëruar thotë: “Ai që i frikësohet Allahut, Ai do t’i gjejë atij rrugëdalje (nga çdo vështirësi)”.¹

2. MBËSHETJA TEK ZOTI

Ai që i mbështetet Zotit është i sigurt edhe pse të gjithë njerëzit i kaplon frika, ai ndihet i qetë edhe pse të gjithë i kaplon stresi, ai ndihet i bindur edhe pse të gjithë janë dyshues, ai ndihet i qëndrueshëm edhe pse të gjithë humbin qëndrueshmërinë, ai ndihet plot shpresë kur të gjithë i kanë humbur shpresat, ai ndihet i kënaqur edhe pse të gjithë shprehin pakënaqësi.

Allahu i Lartësuar thotë: “Në qoftë

1. Kur’ani, Et-Talak: 2.

SI TË MENAXHOJMË STRESIN?

se jeni besimtarë, atëherë mbështetuni tek Allahu”.² “Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet tek Ai...”.³

3. FALJA E NAMAZIT

Pejgamberi (a.s) sa herë që kishte brenga, mërzi e telashe të mëdha falte namaz, siç ka ardhur në hadithin e Hudhejjes: “Kur Pejgamberit (a.s) i vështirësoheshin punët falte namaz”.⁴

Allahu (xh.sh) në Kur’anin Famëlartë thotë: “O ju që keni besuar, kërkonin ndihmë, me durim e me namaz...”.⁵

Kjo botë është bota e gëzimit, por është edhe bota e hidhërimit, është bota e kënaqësisë por është edhe bota e dhimbjes, është bota e të qeshurës, por është edhe bota e të qarës. Zoti shpërblen, por edhe sprovon.

Allahu (xh.sh) thotë: “Ne e dimë mirë, që ty të ngushtohet gjoksi...”, “Andaj, bëj sexhde dhe madhëroje Zotin tënd”.⁶

4. MENDIMI I MIRË PËR ALLAHUN

Allahu nuk të ka krijuar ty për të të dënuar por të ka krijuar për ta adhuruar Atë. Sprovën, sëmundjen, fukarallëkun mos e koncepto si dënim por si rahmet nga Zoti. Allahu do të dëgjojë zërin tënd, a e thërret Atë apo dike tjetër, a kërkon shërim prej Tij apo prej dikujt tjetër, a i nënshtrohesh Atij apo dikujt tjetër.

2. Kur’ani, El-Maide: 23.
3. Kur’ani, Et-Talak: 3.
4. Transmeton Edu Davudi.
5. Kur’ani, El-Bekare: 153.
6. Kur’ani, El-Hixhr: 97-98.

Allahu i Lartësuar thotë: “Mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut”.⁷

Abdullah ibn Mesudi (r.a) ka thënë: “Besimtarit nuk i është dhënë diçka më e mirë sesa mendimi i mirë që ka për Allahun. Sa herë që ai ka mendim të mirë për Allahun, Allahu do ia japë (realizojë) atë gjë për të cilën ai ka mendim të mirë për Të, ngase të gjitha të mirat janë në Dorë të Allahut”.

Në një hadith kudsij Allahu (xh.sh) thotë: “Unë jam tek mendimi që robi im ka për Mua. Nëse robi mendon mirë për Mua, do ta shohë mëshirën dhe faljen Time, që është shumë afër tij. Nëse robi mendon keq për Mua, ashtu do të sillem edhe Unë me atë njeri”.⁸

Ibn Kajjim (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: “Sa herë që njeriu e përmirëson mendimin e tij për Allahun, përforcon shpresën ndaj Tij, mbështetet plotësisht tek Ai dhe Allahu nuk e nxjerr kurrë të zhgënjyer”.⁹

5. DHIKRI, PËRMENDJA E ALLAHUT

Nuk ka ilaç më të mirë për mendjen, zemrën dhe trupin sesa dhikri ndaj Zotit. Përmendja e Allahut i jep zemrës stabilitet, qetësi dhe prehje.

Allahu (xh.sh) thotë: “Ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetësohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut.”¹⁰

Njëherë dikush i tha Pejgamberit (a.s): O i Dërguari i Allahut! Adhurimet janë shtuar shumë e nuk mund t’i bëj dot të gjitha, por më trego për një punë, që po ta bëj, do ta ndjej veten mirë”. Pejgamberi (a.s) i tha: “Mbaje gjuhën të lagur nga përmendja e Allahut”.¹¹

7. Kur’ani, Jusuf: 87.
8. Transmeton Buhariu dhe Muslimi.
9. Medarixhus-Salikin, 1/471.
10. Kur’ani, Err-Rra’d: 28.
11. Transmeton Tirmidhi dhe Ibn Maxheh.

“Kush i kërkon falje Allahut, Ai e çliron atë nga çdo shqetësim, i jep rrugëdalje nga çdo situatë dhe e furnizon atë nga nuk e pret.”

6. ISTIGFARI KËRKIMI I FALJES

Allahu (xh.sh) thotë: “Kërkoni falje nga Zoti juaj, i Cili është Falës i madh”.¹² Hasan El-Basriu ka thënë: “Allahu nuk e ndëshkon atë njeri i cili e ka frikë Atë dhe i kërkon falje Atij”. I Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: “Kush i kërkon falje Allahut, Ai e çliron atë nga çdo shqetësim, i jep rrugëdalje nga çdo situatë dhe e furnizon atë nga nuk e pret”.¹³

7. DUAJA, LUTJA

Umeri (r.a) ka thënë: “Nuk e kam merak përgjigjen e lutjes, por vetë lutjen. Nëse orientohem drejt lutjes, përgjigjja është e sigurt”.

Allahu i Madhëruar na ka urdhëruar që t’i bëjmë dua Atij dhe Ai na ka premtuar se do të na përgjigjet. Ai thotë: “Mu lutni Mua se do t’ju përgjigjem!”.¹⁴ Në një hadithi kudsij Allahu (xh.sh) thotë: “Unë jam me robin tim kur ai më lutet mua”.¹⁵

8. LEXIMI I KURANIT

Leximi i Kur’anit sjell qetësi shpirtërore te muslimani dhe shërim për zemrën, ashtu siç thotë Allahu në Kur’an: “Thuaj: “Ai (Kur’ani) është udhërrëfyes dhe shërim për besimtarët”.¹⁶ Leximi i Kur’anit e qetëson zemrën, e largon mërzinë, e çlodh mendjen dhe, mbi të gjitha, na afron tek Allahu (xh.sh).

Kurani është mjekim për sëmundjet (sociale dhe morale) individuale dhe shoqërore. Allahu i lartësuar thotë: “Kur’ani është shërim dhe mëshirë për besimtarët”.¹⁷

Kurani u dhuron qetësi lexuesve të tij: Ebu Hurejrah (r.a) tregon, se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Sa herë që një grup njerëzish mbledhet në një nga shtëpitë e Allahut duke lexuar dhe studiuar Librin e Allahut, mbi ta zbret qetësia (shpirtërore), i përfshin mëshira, rrethohen nga melekët dhe Allahu i përmend tek ata, të cilët janë tek Ai (tek melekët)”.¹⁸

E lusim Allahun që ta bëjë Kur’anin Famëlartë pranverë të zemrave tona, largim të streseve dhe halleve tona.

12. Kur’ani, Nuh: 10.
13. Transmeton Ebu Davudi dhe Imam Ahmedi.
14. Kur’ani, Gafir: 60.
15. Transmeton Muslimi.
16. Kur’ani, Fussilet: 44.
17. Kur’ani, El-Isra: 82.
18. Transmeton Muslimi, Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxheh.

PËR DASHURINË DHE JETËN

XHAHID BUSHATI, *shkrimtar*

Shënime për librin “Fjalë zemre” të poetes Pranvera Bajraktari, botoi Sh. B. “Fiorentia”, Shkodër, 2020-

Para disa ditësh, poetja e re Pranvera Bajraktari doli para lexuesve me librin e saj të parë të titulluar “Fjalë zemre”, apo për ta vazhduar më tej mendimin e Pranverës “Një leksion ekselent për jetën”, ku shndrisin dhe rrezatojnë si margaritarë: Dashuria dhe Jeta. Citoj nga autorja: “Gjëja më e bukur e dashurisë është Dashuria. / Ajo ecën mbi ujë dhe nuk fundoset kurrë.”

Këto shkurtime që dritësojnë në këtë libër, flasin për urtësi dhe këshilla, përvoja jete, për konceptin e dashurisë, për rolin dhe praninë e njerëzve, për raportet virtut – ves, për familjen dhe ndërtimin e saj, për konceptin e vetvetes, për optimizmin e jetës, për kapërcimin e vështirësive që ndesh njeriu në jetë, për nocionet: kohë, jetë, fëmijë, dituri... etj., etj. Të gjitha këto tipologji janë sjellë dhe shpërfaqur si tekst në mënyrë poetike e diturake. Ata janë ‘leksione’ që duhet t’i mësojnë e t’i dinë të gjitha moshat.

Citoj: “Një ditë e bukur fillon / me një mendim të bukur”. E përmenda këtë urtësi, për të thënë se njerëzorja e shoqëron çdo faqe libri.

Elementi poetik që kanë këto shkurtime, krahas mesazhit të


virtutshëm, mbart në vetvete hapësira të një dashurie të vërtetë, me ndjesi fisnike e njerëzore. Citoj: “Më pëlqejnë rrugët, // ngjarjet, historitë, fjalët meloditë, // që i bashkojnë njerëzit nga njëri cep // në cepin tjetër të zemës. Dhe ‘zemra’ e poetes “shëtiti” në çdo krijim, të cilit i jep dashuri dhe jetë, optimizëm dhe guxim.

Dukuri tjetër që vërejmë në këto shkurtime është se, poetja ruan sensin e masës, përdor një gjuhë lakonike, dhe lë shenjë e mbresa tek lexuesi. Ndaj, dhe krijimet lexohen me një frymë dhe shijohen bukur etikisht dhe estetisht.

Gjithashtu një dukuri tjetër, krahas shumë të tjerave, është dhe ai i kodit të fjalëve që përdor me finesë autorja, si: frymëmarrje, duajeni veten tuaj, gëzojuni jetës, lumturia, mirënjohës e mirënjohje, zemër, e bukura, ... etj.

E lexon dhe e rilexon librin e vlefshëm që i ngjan një enciklopedie të vogël; ku ndalesh dhe merr me vete një dëshirë, një porosi, një figurë, një varg dhe një urtësi... Dhe është bukur të mbash me vete e pranë vetes një libër urtësie! Këtë do ta gjeni tek libri “Fjalë zemre” të autores Pranvera Bajraktari. Edhe pse është libri iparë, autorja vjen me një përvojë leximesh librash dhe jete, vjen me personalitetin e saj. Citoj: 1. “Ëndrra janë si lulet: / Mjafton një shkëndijë e vogël / për t’i bërë të lulëzojnë”, 2. “Fjala guxim / do të thotë të jetosh me zemër!”





H. VEHBI S. GAVOÇI
(1923 - 2013)

"E kisha provuar të vija në Shqipëri në 1974, kur vizitova Kosovën dhe ndenja atje tre muaj, por kur kërkoja të hyja në kufi me Shqipëri nga Prizreni, nuk më lejuan të hyja në vendin tim...por megjithatë unë nuk e mora inat Shqipërinë, pavarësisht se komuniste..."

Do ta kisha vizituar me shumë urrejtje Shkodrën, ani pse e dija se komunizmi i kishte shkatërruar xhamitë...

Ne shqiptarët jemi njerëz të mirë, shumë të mirë dhe në Siri kemi ndërtuar gjysmën e Sirisë... Ne shqiptarët kemi ndërtu shtetet e tjera, po duhet me e ndërtu Shqipërinë mor djema.

Shqipëria asht e bukur dhe e ka fal Zotit (xh.sh) me vende të bukura. Pse me e shkatërru na shqiptarët si në '97?

Jam pikëlluar në 1997 dhe që atëherë s'kam ardhë ma në Shqipëri, por du me e pa për her të fundit Shqipërinë dhe Shkodrën...!"



HAFIZ MUSA DËRGUTI
(1888 - 1961)

"Me akuzën "dijeni për Lëvizjen e Postribës", ishte arrestue edhe i forti Hafiz Musa Dërguti, për të cilin do t'u fliste, se kur kishte qenë në një dhomë parburqimi me Gjon Serreqin dhe i lidhun dorë për dorë me te, ishin pasë çue e ulë sëbashku si të kishin qenë një trup i vetëm, sa herë që gjatë ditës e natës t'i vinte vakti hafizit për me iu falë Zotit, si musliman e si hoxhë që ishte", ose: [Po ashtu i mbështjellë nollash me shami për mungesë mjekre edhe plaku tjetër Hafiz Musa Dërguti, që do kohë ma parë ia kishte la në gjak fytyrën një polici, kur ai i kishte pasë derdhë ujte e "abdesit" aty te truma, e që kur kishte kenë në Sigurim, i kishte pasë thanë një shoku të dhomës:

"Më kërkojnë me folë për priftën, dojnë me na përça, e nesër me thanë se u pushkatuen priftët me dëshmitë e hoxhallarëve. U kam thanë bani çka të doni, se atë punë s'e baj kurr".



HAFIZ ALI KRAJA
(1900 - 1973)

"Sakrificat kanë qenë të mëdha e të shumëllojshme. Nën ime shkonte shumë shpesh dhe e takonte babën në të gjitha burqjet ku ai kreu dënimin, ndërsa ne fëmijët, alternoheshim herë njëri e herë tjetri, deri në momentin që unë u rrita e shkoja e takoja vetë. Babai dënimin e kreu në burqjet e Shkodrës, Tiranës, Maliqit dhe 10 vitet e fundit, i kreu në burqun e Burrelit. Në këtë të fundit, babai u torturua disa herë nga oficerët e burgut me urdhër të eprorëve të tyre."

(Nga dëshmitë e të birit,
z. Mehdi A. Kraja)



HAFIZ QAMIL TRESI
(1922 - 1988)

I thonin: Mbylle xhaminë, mohojë Zotin, se do të japim dyqan e punë të mirë. Por, Hafizi ishte i prerë, ua kthente: "Plumbin ma vini në ballë, por vërtetësitë s'mund t'i mohoj!"... Ai, shpesh përsëriste: "Si ka me ba hajr ky vend, kur ka më se 20 vjet që nuk këndohet ezani muhammedije..?!".

I biri Taxhudini, kujton: "Shpeshherë, kur vinte Ramazani, në syfyr, nëna i mbyllte dritaret me batanije, ose nganjëherë ndizte vetëm një oiri. Njëherë, më kujtohet, ranë sirenat e alarmit, që lajmëronin njerëzit për të hyrë në bodrumet e lagjes, ndërkohë ne kishim kohë që ishim zgjuar dhe të mbledhur pranë sofrës, po hanim syfyr... E kujtoj mirë atë sirenë...!

Shumë herë baba më merrte me vete, kur shkonte për të falur ndonjë xhenaze. Shkonim natën vonë dhe unë rrija poshtë te dera për të ruajtur se mos vinte kush..."



HAFIZ MUSA HOXHA
(1926 - 2020)

"Katër kintal qitabe m'i kanë marrë, megjithëse jam mundu me i fshehtë disa, por pjesa më e madhe është zhdukur. Ju lutem, ma bani hallall... Këto janë pjesë të librave të mi... Kur m'i doqjen librat e bibliotekës, njiu para fshatit, arrita të shpëtoj këto copa... U thoja njerëzve: M'i merrni pjesët e librave... Më ndihmoni t'i shpëtoj librat e mi...! Kështu i kam ruajtur copa-copa qitabet, për mos me i harru...!

Për 25 vjet i kam vendur xhenazet tinëz. I kam kryer këto rite që nga kufiri e deri brenda në Shkodër. Shkoja natën në shtëpinë e të vdekurit. E laja, i qepja qefinin dhe ia falsha xhenazën në dhomë, me katër-pesë vetë të kthyer nga Kibla. Kujtoj një herë që kam shkuar në dymbëdhjetë të mesnatës për të kënduar telkinën e një të vdekuri në Shmitra.

Për 25 vjet kam shkuar gjithandej: Në Shtuf, në Dodaj, në Vallas, në Zues, në Gramosh, në Muriqan, në Oblikë, kudo shkoja... Qëllimi im ishte me u bërë njerëz që me e pasë frikë Zotin, se njerëzia te ne filloi me dalë feje, u bënë ateistat!"



HAFIZ SABRI KOÇI
(1921 - 2004)

Sipas rregullave të burgut, familjarët kishin të drejtë të vizitonin të burqosurit vetëm një herë në muaj. E ashtu nëna e tij plakë e çruaja e mjerë, merrnin rruqën nga Shkodra për në Spaç, me pak ushqime, sepse dhe ata ishin në gjendje të rëndë ekonomike. Hafiz Sabriu kishte lënë nënën, çruan dhe 6 fëmijë në mjerim.

Vdekja e nënës së tij, Zejnepe, në vitin 1976, ishte një humbje e madhe për të dhe për të gjithë familjen. Ajo ishte mbështetje e burim force për fëmijët që rriteshin pa babë, por edhe për zonjën Naime, çruan e Hafizit. Ajo tashmë herë vetëm, herë me ndonjërin prej djemve merrte rruqën e gjatë e të mundimshme për në Spaç, ku atje, para derës së burgut, në borë e në shi, në zhegun e verës e në diell, detyrohej të priste me orë të tëra.

Kështu kaluan 21 vite. Vuante i burqosuri, por jo më pak vuante e gjithë familja.

TUNIZIA (SHTETI MË VERIOR I KONTINENTIT TË AFRIKËS)

Tunizia është një shtet që gjendet në veri të kontinentit afrikan. Në veri dhe në lindje ky vend kufizohet me Detin Mesdhe, në juglindje me shtetin e Libisë, dhe në perëndim me Algjerinë. Kryeqyteti i vendit është Tunisi.

Republika e Tunizisë ka një sipërfaqe prej 163,610 km², ku 40% e territorit të saj është shkretëtirë, kurse pjesa e mbetur është tokë pjellore përgjatë bregdetit.

Popullsia e Tunizisë, sipas Worldmeter(gusht, 2020), llogaritet të jetë 11.837. 509 banorë.

Emri i Tunizisë rrjedh nga emri i kryeqytetit të saj, Tunis, qytet i cili gjendet në bregdetin verilindor të vendit, dhe që në gjuhën berbere do të thotë “vend i shtrirë”.

ANTIKITETI

Në kohët më të hershme të historisë që është e regjistruar, tregohet se Tunizia ka qenë e banuar nga fiset Berbere, kurse bregdeti i saj kanë qenë i banuar nga fenikasit, që në shekullin e 12-të para erës sonë. Në shekullin e 9-të para erës sonë, fenikasit themeluan atje qytetin e famshëm të Kartagjenës. Themeluesit e Kartagjenës sollën kulturën dhe fenë e tyre nga Fenikia (Libani i sotëm dhe zonat rreth tij).

Gjenerali legjendar i Kartagjenës, Hanibali, gati i pushtoi romakët pas hyrjes së tij në Itali, në vitin 216 (p.e.s), por në fund romakët fituan. Ata e shkatërruan Kartagjenën, popullsinë e saj e shpërndanë për skllëvër dhe më pas e rindërtuan atë si një qytet romak, në vitin 44 (p.e.s). Tunizia nën sundimin e romakëve mori një zhvillim të madh, duke krijuar qytetin e shkretuar të tempullit të Dougga-s dhe koloseumin El Xhem.^[1]

Ky vend mbeti nën sundimin e romakëve deri nga mesi i shekullit të shtatë, kohë kur aty erdhën muslimanët.

KLIMA

Klima e Tunizisë është mesdhetare në veri, me dimër të butë e me shi dhe me verë të nxehtë dhe të thatë. Jugu i vendit është kryesisht shkretëtirë. Terreni në veri është malor, i cili, duke

shkuar drejt jugut, kthehet në një rrafsh qendror, me klimë të nxehtë dhe të thatë. Një seri liqenesh kripte, të njohur si “copëza”, shtrihen në linjën lindje-perëndim të vendit, nga Gjiri Kabis, e deri në Algjeri.^[2]

EKONOMIA

Tunizia ka një bazë ekonomike të larmishme, duke filluar nga bujqësia, minierat, prodhimi dhe produktet e naftës, e deri tek turizmi. Sektori i bujqësisë zë 11.6% të PBB-së, industria 25.7%, dhe shërbimet 62.8%. Sektori industrial përbëhet kryesisht nga prodhimi i veshjeve dhe këpucëve, prodhimi i pjesëve të makinave dhe makinerive elektrike. Tunizia është një vend i orientuar kryesisht nga eksporti.



Bashkimi Evropian mbetet partneri i parë tregtar i Tunizisë dhe aktualisht përbën 72.5% të importeve tuniziane dhe 75% të eksporteve tuniziane.^[3]

GJUHA

Arabishtja Standarde është gjuha zyrtare e Tunizisë.

Arabishtja është gjuha që të gjithë folësit e mirëfilltë letrar të Tunizisë e kuptojnë, dhe që mund ta flasin në një farë mënyre. Arabishtja klasike, e përdorur në Kur'an, është konsideruar

si pema nga e cila janë degëzuar të gjitha varietetet e folura të arabishtes, përfshirë arabishten standarde moderne.

Shumica e tunizianëve e flasin gjithashtu rrjedhshëm edhe frëngjishten. Në shkollë, frëngjishtja u mësohet fëmijëve që nga mosha tetë vjeçe. Mbi 60% e popullsisë së Tunizisë janë të arsimuar në frëngjisht dhe gjysma e gazetave tuniziane janë në frëngjisht.

Gjuha e tretë e njohur në Tunizi është Arabishtja Tuniziane. E njohur në vend si Darixha (d.m.th dialektike) ose Tunsu (tuniziane), arabishtja tuniziane është shumë e ndryshme nga arabishtja standarde klasike, ose ajo

moderne. Arabishtja tuniziane ka një fjalor arabisht dhe konsiderohet një derivat i Arabishtes Klasike, megjithatë, shumë nga fjalët e saj janë të huazuara nga frëngjishtja, turqishtja, italishtja, spanjishtja dhe gjuha berbere, kultura të cilat kanë ndikuar në këtë vend të madh.^[4]

FEJA

Islami është feja kryesore dhe zyrtare në Tunizi. 98% e popullsisë së Tunizisë janë muslimanë, ndërsa 2% e tyre janë

ndjekës të krishtërimit, hebraizmit, ose të feve të tjera.

Pjesa më e madhe e tunizianëve i përkasin Shkollës Malikite të Islamit Suni, megjithatë, kur aty erdhën osmanët, ata sollën me vete mësimet e Shkollës Hanefite, shkollë e cila mbijeton edhe sot atje.

ARDHJA E ISLAMIT NË TUNIZI

Përpjekjet e muslimanëve arabë për të marrë Tunizinë filluan që nga viti 27 hixhri, gjatë kohës së Kalifit Othman ibn Affan, Zoti qoftë i kënaqur me të, i cili e kishte caktuar sahabin Abdullah ibn Ebi Serh komandant në krye të një ushtrie të madhe, për marrjen e vendeve të Afrikës. Kjo betejë e ndërmarrë prej tyre, e cila ishte edhe beteja e parë e zhvilluar për marrjen e Tunizisë, u quajt “Beteja e Shtatë Abdullahëve”, sepse shtatë komandantët e kësaj ushtrie quheshin të gjithë Abdullah.

Beteja e dytë u zhvillua në vitin 661 (e.j), dhe përfundoi me marrjen nën kontroll të qytetit Binzart nga muslimanët. Beteja e tretë dhe vendimtare, u drejtua nga komandanti i shquar Ukbe ibn Nafi, në vitin 670 (e.j), pas së cilës ai themeloi qytetin Kajravan, i cili më vonë u bë baza frontale e betejave që do të ndërmerreshin më vonë në Afrikë dhe Andaluzi.

Kajravani ishte qyteti i parë arab, islam, në Tunizi. Atje, komandanti Ukbe ibn Nafi ndërtoi xhaminë e Madhe të Kajravanit, dhe që atëherë filluan shpërnguljet arabe, ku fiset dhe familjet arabe filluan të vinin në Tunizi, duke sjellë kështu një ndryshim domethënës në përbërjen etnike të vendit; arabët u bënë pjesë e rëndësishme e popullsisë, ku më parë shumica e tyre kishin qenë berberë ose fenikas.

Në qyteti e Kajravanit u ndërtuan shumë qendra për studimin e Islamit dhe Tunizia (ose Afrikja, siç i i thoshin muslimanët asokohe), përfaqësonte qendrën e zgjerimeve Islame.

Vrasja e komandantit Ukbe ibn Nafi, në vitin 683 (e.j), pothuajse e dështoi fushatën, dhe muslimanët u detyruan të ndërmarrin një fushatë të katërt dhe të fundit, të udhëhequr nga Hassan ibn Nu'man, në vitin 693 (e.j), dhe e cila e konfirmoi kontrollin e tyre mbi Tunizi, pavarësisht rezistencës së ashpër të treguar nga vendasit amazigë (ose berberët). Muslimanët e morën Kartagjenën në vitin 695 (e.j).



Pavarësisht disa fitoreve të vendasve amazigë dhe rimarrjes së Kartagjenës nga Bizantinët në vitin 696 të erës sonë, përsëri, muslimanët e morën nën kontroll qytetin përfundimisht, në vitin 698.

Kartagjena nuk e rifitoi prestigjin e saj që kishte pasur më parë dhe në vend të saj u zgjodh të ishte qendër porti më i afërt i Tunizisë, i cili u bë vendi nga ku ushtritë muslimane niseshin për luftëra, përmes detit, drejt Sicilisë dhe Italisë jugore.

Muslimanët nuk u mjaftuan me marrjen nën kontroll të brigjeve detare të Tunizisë veriore, por mësynë zonat në brendësi të vendit, për të përhapur Islamin në mesin e berberëve vendas, të cilët që nga ajo kohë u bënë “maja e shtizës” në betejat pasuese, veçanërisht në Andaluzi, të udhëhequra nga Tarik ibn Zijad.

Në vitin 737, në qytetin Tunis, u themelua Universiteti Ez-Zejtuna, institucion i cili kontribuoi në konsolidimin dhe përhapjen e kulturës arabe-islame në rajon, veçanërisht të shkollës Maliki.^[5]

UNIVERSITETI EZ-ZEJTUNA

Universiteti Ez-Zejtuna është universiteti i parë i themeluar në botën islamike dhe konsiderohet një nga universitetet më të vjetër në botë. Leksionet e mbajtura në të janë organizuar që nga viti 737, në Xhaminë Zejtuna, në qytetin Tunis dhe ky universitet luajti një rol të rëndësishëm në përhapjen e kulturës arabe-islame.^[6]

Ndër simbolet (personalitetet) më të spikatura të Universitetit Zejtuna mund të përmendim historianin dhe sociologun e shquar, Ibn Khaldun dhe

dijetarin e shquar Muhamed Et-Tahir ibn Ashur.

IBN KHALDUNI (1332-1406) është cilësuar si babai i disiplinave moderne të historiografisë, sociologjisë, ekonomisë dhe demografisë dhe vepra më e njohur e tij është vepra e famshme “El-Mukaddime”.^[7]

Dijetari **MUHAMED ET-TAHIR IBN ASHUR** (1879-1973), ishte i diplomuar në Universitetin Ez-Zejtuna dhe ka qenë një studiues i njohur musliman. Ai njihet më së miri për veprën e tij “Tefsir Et-Tahrir Vet-Tenvir”, një vepër në interpretimin e Kur'anit Famëlartë, vepër e cila konsiderohet një enciklopedi dijes. Dijetari Ibn Ashur solli një frymë të re në këtë vepër, duke mos i përsëritur thënie të dijetarëve të mëparshme, por duke sjellë ide origjinale, bazuar mbi studimet e tij të gjata. Kjo vepër është botuar në një koleksion të përbërë nga 30 pjesë, me 15 vëllime. Dijetari Muhamed Et-Tahir ibn Ashur bëri një punë të madhe për shkrimin e kësaj vepre, duke u thelluar në kuptimet e Kur'anit Famëlartë dhe mrekullitë e tij.

Përgatiti:
Msc. Arta Ujkaj, teologe

- <https://www.lonelyplanet.com/tunisia/history>
- <https://en.wikipedia.org/wiki/Tunisia#Climate>
- <https://ec.europa.eu/trade/policy/countries-and-regions/countries/tunisia/>
- <https://web.archive.org/web/20130605221847/http://www.tunisia-tourism.org/tunisian-languages/>
- <https://www.marefa.org>
- <https://www.youtube.com/watch?v=RedWeqGj7Q0>
- <https://web.archive.org/web/20130913010235/http://www.muslimphilosophy.com/ik/klf.htm>



Besim Barbullushi - Bursa, Turqi

Sot, ku të gjitha vlerat morale dhe fetare po kalojnë një tranzicion të ndjeshëm, po ndihet nevoja e madhe e ruajtjes dhe krijimit të një muri të fortë edukimi. E para që po e ndien këtë luhatje është familja.

Familja, sipas Islamit, është institucion hyjnor, origjina e së cilës rrjedh që me krijimin e njeriut të parë dhe ka për qëllim vazhdimësinë e jetës. Familja, në qoftë se mund ta quajmë edhe ndryshe, është embrioni i ekzistencës dhe njerëzimi është një produkt i këtij institucioni hyjnor.

Ajo erdhi si një dhuratë, ku Krijuesi i gjithësisë ia dha njeriut ta shijonte në këtë botë. Familja është bashkësia më e vogël e shoqërisë por me rëndësinë më të madhe, aty njeriu lind, rritet dhe merr hapat e parë të edukimit të tij, qoftë ky fetar apo shoqëror.

Kur'ani Famëlartë i ka kushtuar thelbit familjar një rëndësi të madhe, me qëllim që nderi dhe vlera e saj të mbrohet me çdo kusht. Allahu (xh.sh) thotë: “Dhe një prej shenjave të Tij, që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja për njerëzit që mendojnë”. - (Kur'ani, Err-Rrum: 30)

Bazat e familjes janë babai dhe nëna. Këto dy role nuk mund t'i zëvendësojë asgjë, sepse kjo nuk arrihet nëpërmjet rrugëve të arsimit ose të pronësimit.

Për vazhdimësinë e ekzistencës këto dy role nuk janë veç tek njerëzit. Siç e

FAMILJA, NJË INSTITUCION HYJNOR

përmendëm edhe më lartë, Krijuesi ka bekuar mashkullin edhe femrën me një dashuri ku ato plotësojnë njëri-tjetrin dhe frytet e dashurisë së tyre bëjnë krijimin e asaj që quhet familje.

Ashtu siç Krijuesi i bashkoi mashkullin edhe femrën, ashtu edhe ua ndau rolet, ku t'i bëjnë ballë çdo vështirësie, që do i dalë përpara. Atë që mund ta bëjë mashkulli ndoshta s'mund ta bëjë femra, ose atë që mundë ta bëjë femra nuk mund ta bëjë mashkulli, dhe për këtë arsyeje, Krijuesi i krijoi ata të dy, të plotësojnë njëri-tjetrin. Në fenë islame thuhet se nuk ka marrëdhënie më të natyrshme se ato të gjakut dhe se nuk ka shembull më të mirë të intimitetit përveç atij ku gërshetohen morali dhe kënaqësia.

Islame pranon vetëm mënyrën familjare të jetesës, sepse është e vetmja ajo që garanton vazhdimësinë, kjo do të thotë edhe jetë, sepse kur mos të ketë edhe vazhdimësi dhe jetë, atëherë do ketë thjeshtë një fund.

Problemi tek një familje fillon aty edhe ku nuk kuptohen rolet, aty ku mungon autoriteti i babait, përkujdesja e nënës ose edukata e fëmijëve. Në kohët e fundit këto mosmarrëveshje janë rritur shumë dhe kanë bërë që shumë familje të përçahen. Nuk mjaftojnë vetëm problemet e brendshme familjare, por edhe ato të jashtëm, si p.sh: media, teknologjia (interneti), “ndjekja” e shumicës, antivlerat e ofruara si vlera, etj. Në qoftë se shohim statistikën e fundit do vërejmë se divorcet janë rritur dhe gjithashtu do shohim edhe shumë të

moshuar të braktisur nga fëmijët e tyre.

Për një musliman, familja është një bashkim hyjnor dhe mbrojtja e saj është një xhihadë (sakrificë). Duhet kuptuar që familja është një “zemër” që mban gjallë këtë dynja, nuk është thjesht bashkimi i një çifti, por titulli “familje” ju jepet atyre që e meritojnë.

Pejgamberi Muhammed (s.a.v) në një hadith thotë: “Martesa është pjesë e praktikës sime jetësore dhe kushdo që i largohet praktikës sime jetësore, nuk është prej nesh”.

Në vazhdimësinë e kësaj bote, përveç se një lidhje e shëndoshë familjare, nuk ka një zgjidhje tjetër, çdo lidhje tjetër, qoftë kjo jo nën ombrellën e hallallit, ose qoftë kjo një lidhje e një gjinie të njëjtë, nuk do jetë frutdhënëse përderisa është krijuar mbi themele, të cilat Krijuesi i ka bërë të ndaluara dhe të dëmshme për robëritë e Tij.


Ta duash familjen, ta mbrosh atë, t'i përgjigjesh asaj për çdo nevojë, të bëhesh shkak që ajo të ndjekë rrugën e drejtë, ka shpërblimet e një ibadeti, dhe kjo ka një meritë të madhe tek Krijuesi.

Ajo që është më e rëndësishmja në këto kohë, është edukimi i brezave të ri. Të edukohen me vlera patriotike dhe fetare. T'u tregohet se të mbrosh vlerat morale nuk është prapambetje, por është personalitet dhe karakter i formuar. Brezat e rinj duhet të jenë shumë të fortë dhe të qëndrueshëm ndaj çdo stuhie anti morale dhe anti vlere që iu ofrohet.

“Ne e kemi obliguar njeriun të sillet mirë ndaj prindërve të tij”. - (Kur'ani, El-Ankebut: 8) Asnjë prind nuk mund t'i dhurojë fëmijës së tij, diçka më të çmuar, se sa një edukatë të mirë.

Një edukatë e mire do të thotë një familje e shëndoshë, një familje e shëndoshë do të thotë një komunitet i moralshëm, e një komunitet i moralshëm do të thotë një botë më e qetë dhe e paqetë!

Një edukatë e mire do të thotë një familje e shëndoshë, një familje e shëndoshë do të thotë një komunitet i moralshëm,..




...E NJË KOMUNITET I MORALSHËM DO TË THOTË NJË BOTË MË E QETË DHE E PAQETË!

ARKITEKTI TURK: NË 18 VENDE, 329 XHAMI DHE MONUMENTE OSMANE U SHNDËRRUAN NË KISHA

Arkitekti turk Mehmet Emin Yılmaz ka kryer një hulumtim mbi monumentet osmane në territorin e shtetit të dikurshëm osman dhe ka zbuluar se gjithsej 329 xhami, faltore, teqe, tyrbe dhe monumente të tjera kulturore osmane në 18 vende janë shndërruar në kisha.

Gjatë dhjetë viteve të fundit, Yılmaz ka udhëtuar në vende që dikur ishin pjesë e shtetit osman dhe ka identifikuar dhe numëruar objektet osmane që janë shndërruar në kisha, përfshirë minaret që janë shndërruar në kulla kambanash.



Duke folur për Anadolu Agency (AA), ai tha se kërkimet i ka filluar në Ballkan dhe më pas është përqendruar në Hungari, Bullgari dhe Greqi, ku gjenden shumica e objekteve osmane, të cilat me kalimin e kohës janë shndërruar në kisha.

“Objektet turke janë kthyer në kisha për arsye politike dhe hapësinore-demografike. Minaret dhe xhamitë në qendrat e qyteteve të mëdha ishin një simbol i Islamit dhe qeverisjes osmane në atë kohë dhe ishin objektivi i parë që u shkatërruan pas rënies së shtetit osman. Vetëm në një natë në vitin 1878, shtatë minare u shkatërruan me dinamit në Sofje”, tha Yılmaz.

Në Greqi, më shumë se njëqind ndërtesa osmane janë shndërruar në kisha dhe kulla kambanash, përfshirë 74 xhami, 19 tyrbe, një imaret, një faltore dhe pesë minare.

Ai theksoi se disa nga ato objekte janë shndërruar në kisha për arsye të thjeshta hapësinore-demografike, sepse lagjet përreth xhamive ishin të banuara

nga të krishterët.

“Më shpesh, në kisha janë shndërruar xhamitë dhe faltoret dhe unë kam regjistruar 272 raste të tilla. I njëjti fat u ndodhi teqeve, tyrbeve, hamameve dhe objekteve të tjera të arkitekturës osmane” tha Yılmaz.

Ai shtoi se në përgjithësi, në objektet në fjalë, po ashtu janë fshirë të gjitha gjurmët klasike osmane.

Yılmaz gjithashtu tha se xhamitë dhe faltoret janë ndërtuar me murin kryesor në drejtim të Kiblës dhe falë

kësaj veçorie, ai ka zbuluar Xhaminë e Mustafa Pashës, e cila sot është një kishë në Budapest.

Nga ana tjetër, ai thotë se në rastet e ndryshimit të qëllimit të ndërtesave në Turqi, nuk ka pasur ndonjë ndryshim të rëndësishëm në arkitekturën dhe karakteristikat themelore të atyre ndërtesave.

“Asnjë komb nuk respekton arkitekturën e ndërtesave aq sa turqit. Pa asnjë kompleks nga e kaluara, turqit nuk ndryshuan karakteristikat e ndërtesave që ishin shndërruar në xhami. Shembulli më i mirë i kësaj është Ayasofja. Që nga viti 1453, ne e kemi ruajtur si sytë e ballit dhe nuk kemi ndërhyrë në tiparet e saj kishtarë. Ne vetëm kemi shtuar mihabin, minberin dhe minaret. Nga pamja e saj sot mund të konkludoni se dikur ishte kishë. Kështu është edhe në brendësi. Nga ana tjetër, evropianët që i kthyen xhamitë në kisha shkatërruan të gjitha tiparet origjinale”, tha Yılmaz.

(www.aa.com.tr/sq)

TI NUK MUND TË PISH, SE SHKON NË XHAMI!

HAXHI GENTI LIKA

Kisha vetëm pak ditë që frekuentoja xhaminë. Ah... ato ditë të kaluara!

Një ditë na fton daja për drekë për ditëlindjen e vajzës. Te daja shkoja me qejf. Fëmijët e tij ishin pothuaj moshatarë me mua. Erdhi vakti i drekës. Tavolina plot. Me gjithë të mirat. Nusja e dajës ishte shumë e zonja në gatim. Specialitet kishte përseshin me pulë. Krahas kësaj te daja mund të gjeje të gjitha pijet alkoolike të kohës, për burra e gra. Nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Daja punonte revizor në Kombinatin Ushqimor. Teksa u ulëm në tavolinë dhe po shijonim gatimet e shijshme, daja na pyet një për një për pijen e preferuar.

- Daja, - mua më mbush pak birra. - i thashë.

- Ti, jo, - më tha daja dhe e largoi shishen.

- Pse? - pyeta unë i çuditur.

- Se shkon në xhami. Ata që shkojnë në xhami nuk pinë alkool.

Qysh atë ditë unë nuk e kam vënë në gojë alkoolin. Nuk është se kisha ndonjë preferencë të madhe për pijet, thjesht më tërhiqnin ngjyrat e tyre. Sot, pas pothuaj 29 vitesh më tingëllojnë në vesh fjalët e dajës sim:

- Ti jo, nuk mund të pish, se shkon në xhami.

Edhe pse nuk kishte njohuri fetare, ai e dinte se që të shkosh në xhami duhet të jesh larg nga veset, një prej tyre alkooli.

Unë u rrita mes këtyre njerëzve, të cilët edhe pse nuk kishin njohuri rreth fesë, respektonin parimet e saj dhe ishin të bindur për ndikimin pozitiv të saj te njerëzit.

Më mungon i vetmi dajë që kam.

Më mungojnë fëmijët e tij.

Më mungojnë gatimet e shijshme të nuses së dajës, pritja e përzemërt e saj, por mbi të gjitha, më mungon gjyshja ime...

Naime Tabaku, qytetarja nga Mitrovica, e vogël në trup, por madhështore në shpirt. Ajo grua zonjë, e cila, teksa më përcillte, nuk harronte të më fuste në dorë 10 lekëshin letër për akulloren time të preferuar.

Unë vërtet jam rritur i varfër, por kam pasur një fëmijëri të pasur me njerëz të mirë e me kujtime të bukura.

DËSHMITË E TË GJITHË ATYRE QË I MBIJETUAN ÇNJERËZIMIT, SHTYPJES E LIGËSISË, JANË TË RËNDËSISHME

ARDITA REPISHTI

Djaloshi me sytë e trishtuar në foto, është babi kur ishte 13 vjeç, pak javë para se ta internonin në Tepelenë, me motrën 15 vjeçe dhe nanën e shumëmunduar. Vëllai i madh, Samiu, ishte arrestuar që në 1945 dhe vuante dënimin në burgjet kampe të punës së detyruar. Vëllai tjetër, Fahriu, 22 vjeçar, u arratis nga malësia e Mbishkodrës, për t'i dhënë vetes mundësinë e jetës në liri.

Zgjedhja e tij e jo vetëm, ndikoi jetën e familjes së mbetur në shtëpinë qindvjeçare në Shkodër. Babi tregonte se kur u erdhi kamioni te shtëpia dhe u dha një orë kohë për t'u bërë gati se do të internoheshin, në rrëmujën e ngutit me të cilin e ëma dhe e motra merrnin sendet personale e ato të domosdoshme për të jetuar, ai vraponte nëpër shtëpi që të gjente strajcë për të futur librat e dhuruar nga shkolla, si nxënësi më i mirë. Kishte idenë se do t'i duheshin atje ku do të shkonte, pa qenë fare i përgatitur për çfarë e priste.

Familja u largua nga shtëpia qindvjeçare dhe e la derën hapur. U ngushtuan mbi kamion me dajën, kushërinjtë dhe familjarë të tjerë të arratisurish, për ta mbajtur frymën në kalanë e Beratit.

Atje qëndruan disa kohë, në kushte të vështira, të pamundura, me shumë familje të tjera të veriut, që shtoheshin dita-ditës. Në kujtimet e babit kishte beratas fisnikë, që ndihmonin të ardhurit me sa kishin mundësi. Kishte hutim për jetën në mjediset e papërshtatshme të kalasë dhe mirënjohje për moshatarët vendas që i mbajtën afër, të cilët, pas 40 vjetësh, ai shkoi t'i kërkonte e takonte.

Nga Berati, familja e mbetur Repishti u transportua për në Turan të Tepelenës.

Këtu babi nuk donte të fliste më. Kujtimet e tij ishin të copëzuara, të ngarkuara me dhimbje, shumë rrallë i ndau me ne.

Miku i tij në internim që e takova më vonë duke i kërkuar të më fliste për të, më thoshte se ishte e natyrshme. Njeriu s'e ka të lehtë të flasë e tregojë për një kohë kur është gjithnjë i poshtëruar. Pa folur për të tjerat.

Historitë e babit, hallës e gjyshes në Tepelenë janë të pakta. Me vështirësi i kam mbledhur nga shprehjet e tyre, kujtimet apo bisedat me axhën, i cili

më shumë se të gjithë mban mend, i ka jetuar në vetë të parë dhe mund t'i lidhë të gjitha.

Pastaj lirimi, pritja gati njëvjeçare në kamp se nuk kishte makinë për t'i larguar që atje, dhe rikthimi në ahurin e shtëpisë në Shkodër, të banuar e keqpërdorur nga të tjerë, por prapë, shumë e dashur para tmerreve të Turanit e Tepelenës.

Dhe përpjekjet për mbijetesë, përshtatja me realitetin e ri, ku në



*Velbi Ibrahim Repishti
lindur në Shkodër
Pajë Dudas 14 qershor 1935
Foto është bërë në muajin
Shkurt 1944, dy javë para
internimit në qytetin Berat
dhe në kampin famëkeq
te Turanit, Bengë e Veligot
te Tepelenës.
Kjo foto e ralisë tregon
gjendjen shpirtërore e
psikologjike të momenteve
që kalojshim në prag të
dëbimit nga vend-ëndaja dhe
të afërmit të tjerë.
SHKODER
Dhjetor 2006
Velbi Repishti
Jovanovic*

shtëpinë e vet, në lagjen e vet, në qytetin e vet, ai ishte i mituri i kthyer nga internimi, me vëllanë në burg, vëllanë tjetër të arratisur, largimet e njëpasnjëshme nga shkolla, punët e rëndomta, djegia e shpresës për më mirë...

Këtë fotografi dhe tekstin shpjegues nga pas e gjetëm në shtëpi, në kopje për secilin nga ne, pasi u kthyem nga Tirana, ku babi nuk i mbijetoi sëmundjes. Sirtari i tij me letra, kujtime, shënime, dokumente, ishte sistemuar në përsosuri. Ai kishte riprodhuar foton e dëmtuar të fëmijërisë për ne të gjithë. Pa bujë, në heshtje.

Teksti i shkruar nga pas, i cili nis në vetë të tretë, është dëshmia e vetme me shkrim që më ka lënë babi për Tepelenën.

Vlerën e tij e kuptova kur ai nuk ishte më e nuk mund të përgjigjej. Dhe sa shumë pyetje ka...

Sa shumë nevojë për të ditur, njohur, kuptuar, thelluar, reflektuar, vepruar, ndërmarrë...

Kanë kaluar mbi dhjetë vjet që babi

nuk është më. Emri i tij, as i gjyshes sime fisnike nuk figuron në regjistra internimi e dënimi, sikur të mos ishin larguar kurrë nga shtëpia, të mos kishin kaluar mundimet e kalasë së Beratit, tmerret e Turanit e Tepelenës, të mos kishin jetuar përherë në trysni... Ata mbyllën sytë dhe duket sikur nuk kanë qenë kurrë....

Jo vetëm ata. Shumë si ata... Fëmijët që u tretën në Tepelenë e jo vetëm, familjarë të tyre, sa e sa

histori të pabesueshme që mbetën pa rrëfyer, që mezi zbulohen në kujtimet e bashkëkohësve që ikin dita-ditës dhe fiken, bashkë me zërat e tyre.

Dëshmitë e të gjithë atyre që i mbijetuan çnjerëzimit, shtypjes e ligësisë, janë të rëndësishme.

Ata i sjellin në të sotmen fatet e njerëzve tanë, i japin ngjyra asaj ane të historisë për të cilën është bërë kujdes të asgjësohen apo tjetërsohen dokumentet, por jeta dhe fryma mbeten, edhe kur nuk duken, edhe e vërteta...

Këtë foto e mbaj pranë vetes.

Babi më sheh i trishtuar, fëmijë, nga një dimension që unë nuk ia njoha kur ishte me ne.

Por babi 13 vjeç, në pritjen e ankthshme të të panjohurës, ka një forcë që nuk mund ta gjej gjithkund.

Babi im fëmijë, i bardhë, i pafaj e fisnik, nuk flet, por thotë shumë; nuk bën, por vepron, nuk ndërmerr, por vendos.

Sa histori mund të lidhen me një foto, ku kohët nuk janë rend kronologjik...

LETËR INTERESANTE NGA ARKITEKT SINANI

Para disa vitesh, një ekip i formuar nga arkitektët dhe inxhinierët më kompetent, si shkak i përballjes me rrezikun e rrënimt të Xhamisë Sulejmanije, vendosën që t'i hulumtojnë të gjitha harqet që bartnin peshën e xhamisë.

Në brendësinë e harkut gjendej një ndarje e cila ua tërhoqi vëmendjen ekipit.

Në atë ndarje, mes gurëve gjejnë

teknika e ndërtimit, rindërtimi i tyre sipas origjinalit mund të jetë i vështirë. Prandaj për t'ju ndihmuar sadopak, po ju përshkruaj hapat që kam ndjekur gjatë ndërtimit..."

Në vazhdim Sinani përshkruan vendin nga i kishte marrë gurët, mënyrën e gdhendjes, radhën e vendosjes dhe detajet tjera.

Komisioni vepro i ashtu si u kishte thënë Sinani. Kështu që Xhamia



“Sipas meje, këto qurthemele mund t'i përballojnë rreth 400 vite. Në ndërtimin e tyre është përdorur një teknikë e veçantë. Duke marrë parasysh që pas 400 vitesh do të ketë ndryshuar teknika e ndërtimit, rindërtimi i tyre sipas origjinalit mund të jetë i vështirë. Prandaj për t'ju ndihmuar sadopak, po ju përshkruaj hapat që kam ndjekur gjatë ndërtimit...”

të murosur një shishe të mbyllur mirë. Brenda saj ishte një letër e mbështjellë në gjuhën osmane që mbante nënshkrimin e Arkitekt (Mimar) Sinanit.

Në letër shkruante kështu: “Pasi ta keni gjetur këtë shkrim, sigurisht njëri nga gurthemelet e harqeve është gërryer dhe ju nuk dini si ta ndërroni.”

“Sipas meje, këto qurthemele mund t'i përballojnë rreth 400 vite. Në ndërtimin e tyre është përdorur një teknikë e veçantë. Duke marrë parasysh që pas 400 vitesh do të ketë ndryshuar

Sulejmanije u shpëtua nga rreziku. Kjo letër, për momentin, gjendet në Pallatin Topkapi.

Nga kjo letër del dhe një herë në pah zotësia dhe mendjemprehtësia e mjeshtrit shqiptar. Që të linte këtë mesazh atij i duhej që të njhte mirë llojin dhe jetëgjatësinë e gurëve, të gjente letër dhe ngjyrë që do të rezistonin 400 vjet, të parashikoj ndryshimin e teknikave të ndërtimit në shekuj dhe, mbi të gjitha, të mbartte përgjegjësinë për t'ia lënë veprën e tij edhe brezave pas 4 shekujsh.

TURQIA ZBULON 320 MILIARDË M³ GAZ NATYROR NË DETIN E ZI



Presidenti Recep Tayyip Erdogan njoftoi të premten, më 21 gusht 2020, se Turqia ka realizuar zbulimin e saj më të madh historik të gazit natyror në Detin e Zi.

Duke dhënë lajmin e madh dhe të shumëpritur nga zyra e tij në Pallatin “Dolmabahçe” të Stambollit, Erdogani tha se anija e sondimit “Fatih” ka zbuluar 320 miliardë m³ gaz natyror në pusin “Tuna 1”.

“Këto aktivitete i kemi bërë plotësisht me mundësi vendëse. Objektivi është që gazi natyror të Detit të Zi ta vëmë në shërbim popullit tonë deri në vitin 2023”.

Sipas tij, të dhënat e siguruar nga ky pus tregojnë se rezerva të reja ka shumë gjasa të zbulohen në të njëjtën zonë.



“Me lejen e Allahut, lajme të mira si ky presim edhe nga Mesdheu. Jemi të vendosur për të zgjidhur rrënjësisht çështjen energjetike të vendit tonë”, theksoi kreu i shtetit turk mes të tjerash.

“Tani do të kalojmë menjëherë në hapjen e puseve të përcaktuara dhe duke përcaktuar edhe prodhimin do të fillojmë punimet e ndërtimit dhe strukturimit”, theksoi Erdogan.

(www.radiojehona.al)

NOTRE-DAME, BIG BEN DHE VENEDIKU “ISLAMIK”... ORIGINAT LINDORE TË ARKITEKTURËS PERËNDIMORE

Oliver Wainwright

Kur Katedralja e Notre-Dame u përpi nga flakët vitin e kaluar, me mijëra vetë vajtuan humbjen e këtij fanari madhështor të civilizimit perëndimor. Simboli fundor i identitetit kulturor francez, vetë zemra e kombit, po shndërrohej në shkumb e hi. Por ekspertet e Lindjes së Mesme, Diana Darke, i bluante në kokë tjetërçka. Ajo e dinte mirë se origjina e kësaj ngrehine madhështore gotike nuk shtrihej në analet ‘e pastra’ të historisë së krishterë evropiane, sikundërse shumëkush ka supozuar gjithnjë, por në shkretëtirat malore të Sirisë, në një fshat në perëndim të Halepit për të qenë më të saktë.

“Projekti arkitekturor i Notre-Dame, si të gjitha katedralët gotike në Europë, vjen drejtpërdrejt nga kisha e shekullit të pestë në Siri e quajtur Qalb Lozeh,” shkruajti në Tweeter Darke mëngjesin e 16 prillit, teksa pluhuri akoma nuk kishte rënë në Paris. “Kryqëtarët sollën në Europë konceptin e “kullave binjake në krah të dritares trëndafil” në shekullin e dymbëdhjetë.”

Nuk janë vetëm kullat binjake dhe dritarja trëndafil që i kanë rrënjët e tyre në Lindjen e Mesme, vë ajo në dukje, por gjithashtu edhe kubeja e hullizuar, harakadat e thyera, dhe madje edhe receta për vetrazhet me qelq të bojatisur. Arkitektura gotike, sikundër e njohim ne, i detyrohet shumë më tepër trashëgimisë arabe dhe islame se sa ç’i detyrohet gotëve të harbuar. “Ngela e befasuar nga reagimi,” thotë Darke. “Mendoja se shumë më tepër njerëz e dinin këtë, por duket se ekziston një hendek i madh injorance në lidhje me historinë e përvetësimit kulturor. Në sfond të një Islamofobie gjithnjë e në rritje, gjykova se ka ardhur koha që dikush të hedhë dritë mbi këtë narrativë.”

Në librin *Grabitja nga Saraçenët* (Stealing from the Saracens), një libër i gjallë dhe me një punë kërkimore skrupuloze që hedh dritë mbi shekujt e huazimeve, ajo gjurmon rrënjët e ndërtesave kryesore të Europës – nga Selitë e Parlamentit në Londër dhe Westminster Abbey deri katedralja Chartres dhe bazilika e Shën Markut në Venedik – tek pararendëset e tyre në Lindjen e Mesme. Është po aq një rrëfenjë e pushtetit politik, pasurisë dhe modës sa ç’është edhe e besimit fetar, me tregimet e kryqëtarëve që

plaçkitnin, peshkopë të dhënë pas modës dhe tregtarë që shkelnin në çdo qosk të globit ku zbulonin stile dhe teknika të reja dhe i sillnin ato më pas në vendlindje.

“Sot kemi nocionin e lindjes dhe perëndimit,” thotë Darke. “Por në atë kohë, nuk ka qenë aspak kështu. Ka patur shkëmbime të mëdha kulturore – dhe pjesa më e madhe vinin nga lindja në drejtim të perëndimit. Anasjelltas qarkullonte fare pak.”



Më tepër arabe se evropiane ... Kubeja e Shkëmbit në Jeruzalem, majtas, dhe bazilika e Shën Markut në Venedik, apo Venecia. Kompozit: Godot13/Zairon

Po të kemi parasysh mbizotërimin e tyre në katedralët e mëdha të Europës, është e lehtë që të imagjinohet se arkadat e thyera me gurë dhe kubetë e hullizuara janë me origjinë të krishterë. Por të parat i kanë rrënjët në një faltore islame të shekullit të shtatë në Jeruzalem, ndërkohë që të dytat patën fill në një xhami të shekullit të dhjetë në Andaluzi të Spanjës. Në fakt, shembulli i parë i kubesë së hullizuar është ende në këmbë sot e kësaj dite. Vizitorët në Cordoba Mezquita mrekullohen para harkadave të shumëfishta që ndërthuren në një kryevepër të gjeometrisë praktike dhe strukturës ornamentale, duke mos e ndërë kurrë nevojën për qoftë edhe një riparim të vetëm në një mijë vitet e ekzistencës së saj. Maksura me kube – pjesa e xhamisë që i rezervohej kalifit sundimtar – ishte e projektuar që të hidhte një vezullim shenjtëruës mbi udhëheqësin. Megjithatë, fletushka zyrtare që gjendet sot aty të tregon pakogjë për prejardhjen islame të ndërtesës, ndoshta për shkak se që nga viti 1236 ajo është shndërruar në kishë katolike.

Harkada e thyer, nga ana tjetër, ishte një zgjidhje pragmatike për një problem

që e hasën muratorët që punuan për Kubenë e Shkëmbit në Jeruzalem. Njëra nga vendet më të shenjta në botën myslimane, ajo u ndërtua në vitin 691 nga sundimtari i perandorisë së parë islame. Sfida ishte se si të përvijohet një harkadë e jashtme me harqe të rrumbullakëta me një harkadë të brendshme më të vogël, ndërkohë që të ruhej një tavan horizontal ndërmjet tyre. Në mënyrë që të çarat të radhiteshin drejt, ndërtimtarët duhet t’i jepnin harkadës së brendshme harqe

më të ngushta, duke i detyruar ato që të bëheshin me majë, pra të thyera. Një tjetër element që është prurë për herë të parë mund të pikaset më lart në faltore, atje ku kubeja rrethore është një harkadë me harqe të trefishta, një stil i harkut me tre lobe që më vonë praktikisht pranoi çdo katedrale evropiane, i përvetësuar me zell si një simbol i Trinisë së Shenjtë.

“Tronditem pareshtur,” thotë Darke, “se sa shumë nga këto elementë që ne i mendojmë si thelbësishëm të krishtera dhe evropiane janë të bazuara mbi injorancën dhe keqinterpretimin e formave islame shumë të mëhershme.” Ajo vë në dukje se ndikimi i pamasë i Kubesë së Shkëmbit kaloi tek kryqëtarët e mesjetës të cilët gabimisht mendonin se ndërtesa ishte Tempulli i Solomonit.

Ata përdorën planin rrethor me kube të kësaj faltoreje që ata supozonin se ishte e krishterë si model për kishat e tyre tempullare (siç është Kisha e Tempullit në Londër), madje duke kopjuar edhe mbishkrime dekorative arabe, të cilat qortojnë haptazi të krishterët që besojnë në Trinitet dhe jo Zotin një. Modelet e tyre kaligrafike pseudo-kufase stolisën më vonë edhe punimet në gurë të katedraleve franceze

dhe bordurat e tekstileve të endura me mjaft luks, pa qenë askush i vetëdijshëm se çfarë kuptimi kishin ato në të vërtetë.

Pështjellimi u përhap edhe më tutje falë hartës së parë të shtypur të Jeruzalemit, e botuar në Mainz të Gjermanisë, në vitin 1486. Harta në fjalë jo vetëm që e emërton gabimisht Kubenë e Shkëmbit si Tempulli i Solomonit, por madje edhe e përshkruan ngrehinën me një kube të shkëlqyer me majë që zvogëlohet, pak a shumë në formë qepe – një fantazi e kulluar orientaliste nga mendja e një artisti hollandez i gravurave prej druri të quajtur Erhard Reeuwich. Libri ku gjendej harta u bë një bestseller i kohës, duke u rishtypur 13 herë dhe përkthyer në shumë gjuhë, dhe duke influencuar kësodore përhapjen e kishave me kube me që zvogëlohet në mbarë Evropën e shekullit të gjashtëmbëdhjetë. Bëhet fjalë për një rrëfenjë të ngatërrimit të identitetit dhe të pasojës së paqëllimshme që është e denjë për një skeç nga Monty Python (kolektiv humoristësh britanikë, ngjashëm me “SHBLSH” sh.p.).

Megjithatë, transferimi i motiveve islame drejt perëndimit nuk ka qenë gjithnjë kaq i thjeshtë. Harku i thyer ndoqi një rrugë disi më të gjatë. Darke gjurmon se si harqet u përhapën fillimisht në Kajro, duke u bërë me të mprehtë dhe më me majë në periudhën e Perandorisë Abasite, dhe se si u soditën me admirim nga tregtarët vizitorë nga porti i pasur italian i Amalfit, të cilët i kanalizuan zbulimet e shtegtimeve të tyre në bazilikën e tyre eklektike të shekullit të 10. Kjo ndërtesë ekzotike amalfitane ra në sy të Abatit Desiderius, i cili vizitoi Amalfin në vitin 1065 në një udhëtim që kishte për synim blerjen e mallrave të rrallë të luksit, dhe vendosi që të merrte dizenjën e dritares së thyer për manastirin e tij në

Ato dritare u kopjuan më pas për abacinë benediktine në Cluny në Francë, kisha më e madhe në botën e asaj kohe. Abatit Suger, këshilltar i mbretërve Luigji VI dhe Luigji VII, i pëlqeu fort se si dritaret linin që të hynte më tepër dritë, dhe zbatoi menjëherë të njëjtin dizajn në bazilikën e tij të Sën Denisit në Paris. E konsideruar si struktura më e hershme plotësisht gotike, bazilika në fjalë u përfundua në vitin 1144 dhe arkitekti i saj më vonë punoi në Notre-Dame. “Të gjithë e kopjuan atë,” thotë Darke. “Këto ishin kishat më të fuqishme në Europë, kështu që stili u bë plotësisht i suksesshëm, siç ndodh rëndom me të gjitha gjërat që bëhen modë. Kur njerëzit

NË LIBRIN GRABITJA NGA SARAÇENËT (STEALING FROM THE SARACENS), NJË LIBËR I GJALLË DHE ME NJË PUNË KËRKIMORE SKRUPULOZE QË HEDH DITË MBI SHEKUJT E HUAZIMEVE, AJO GJURMON RRËNJËT E NDËRTESAVE KRYESORE TË EUROPËS – NGA SELITË E PARLAMENTIT NË LONDËR DHE WESTMINISTER ABBEY DERI KATEDRALJA CHARTRES DHE BAZILIKA E SHËN MARKUT NË VENEDIK – TEK PARARENDËSET E TYRE NË LINDJEN E MESME. ËSHTË PO AQ NJË RRËFENJË E PUSHTETIT POLITIK, PASURISË DHE MODËS SA Ç’ËSHTË EDHE E BESIMIT FETAR, ME TREGIMET E KRYQËTARËVE QË PLAÇKITNIN, PESHKOPË TË DHËNË PAS MODËS DHE TREGTARË QË SHKELNIN NË ÇDO QOSHK TË GLOBIT KU ZBULONIN STILE DHE TEKNIKA TË REJA DHE I SILLNIN ATO MË PAS NË VENDLINDJE.

e fuqishëm përvetësojnë diçka, të gjithë fillojnë ta duan atë.”

Lista vazhdon. Kemi minaret e hershme katrore, që gjenden në ndërtesa të tilla si Xhamia e Madhe e Damaskut, që janë si kon dhe bëhen më të holla në majë dhe janë të kurorëzuara me një kube ornamentale në majë në formë poçi. Këto frymëzuan kullat e mëdha italiane siç janë ato të bashkisë së Firences, dhe të Campaniles, Këmbanarës, së Shën Markut në Venedik, duke përfigurizuar shekujt të këmbanave kishtare.

Duke përdorur si burim punën kërkimore të historianes së arkitekturës Deborah Howard, Darke tregon se Venecia ka qenë më tepër arabe se evropiane, që nga vendkalimet e ngushta gjarpërueshe dhe shtëpitë me oborr me hajat në çati, e deri te ornamentimi islamik i Pallatit të Doxhëve (modeluar sipas Xhamisë al-Aksa në Jeruzalem) dhe kubetë gjysmë rrethore të Shën Markut. Të gjitha ato janë fryt i udhëtimeve të bëra nga tregtarët venedikas në Egjipt, Siri, Palestinë dhe Persi, të mburjtura edhe me një nivel ndikimi që shtrihej madje edhe në modë: gratë në Venedik dilnin në publik të mbuluara me vel dhe rrinin të veshura me të zeza nga koka gjer te këmbët. “Fytyrat e tyre nuk mund të shihen gjallë në botë,” komenton një burim i shekullit të pesëmbëdhjetë. “Ato

dalin në rrugë aq të mbuluara, saqë unë nuk e kuptoj se si ato arrijnë të shohin rrugën.”

Libri vjen në një kohë të ngarkuar, kur arkitektura e presupozuar si perëndimore po mobilizohet nga grupet nacionaliste të ekstremit të djathtë për të fuqizuar vizionin e tyre të idealizuar për një identitet “të pastër” evropian. Sot në mediat sociale ka profile pa fund që promovojnë mesazhet e supremaciës së bardhë të maskuara si vlerësime qeveritare të nxjerra së fundmi në lidhje me traditën dhe bukurinë bartin nuanca të ngjashme. Vepra e Darke është një goditje plot elokuencë për një propagandë të tillë të stilit ‘gjellë-qensh’ të rrëmbushur me injorancë dhe që shpalos se si monumentet e idealizuara nga alt-right i kanë rrënjët e tyra pikërisht në kulturën për të cilën ata ngrejnë aq shumë dyshime.

Injoranca është gjerësisht e përhapur, dhe ndoshta gjëja më befasese në librin *Grabitja nga Saraçenët* është se shumëçka që shkruhet aty nuk ka përse të jetë aspak befasese për lexuesin modern. Tekefundit, përgjatë gjithë librit, Darke evokon fjalët e Christopher Wren, i cili ishte fort i vetëdijshëm për origjinën mediorientale të arkitekturës gotike, dhe për teknikat strukturore që ai përdori në Katedralen e Shën Palit në Londër.

“Stili gotik modern,” shkruante ai në vitet 1700, “spikat nga lehtësia e punës, nga guximi i ekzagjeruar i lartësive... nga delikatesa, shkapërderdhja dhe imagjinata ekstravagante e ornamenteve ... Prodhime të tilla, kaq të gjera, nuk mund t’i pranojnë gotët hijerëndë si autorë të tyre.” Më saktë, konkludonte ai, “nga të gjitha shenjat, kjo arkitekturë e re mund t’i atribuohet vetëm Maorëve; apo atyre që janë e njëjta gjë, arabëve apo saraçenëve.”

Ironia këtu gjendet tek vetë emri: në kohën e Wren, saraçen ishte një term pezhorativ për myslimanët arabë, kundër të cilëve kryqëtarët kishin bërë edhe të tyren “luftë të shenjtë”. Fjala saraçen zuri fill nga fjala arabe “saraka”, që do të thotë “të vjedhësh”, pasi saraçenët shiheshin si plaçkitës dhe hajdutë. U harrua se Kryqëtarët plaçkitën ç’të mundnin në shtegun e tyre nëpër Europë, Jeruzalem dhe Konstandinopojë – duke vjedhur edhe mrekullitë e arkitekturës islamike përgjatë rrugës, dhe duke i praruar me bojë origjinat e kësaj plaçke të tyre në rrugë e sipër.

Përktheu: **Arjol Guni**
(www.erasmusi.org)



"Biri im,

ruaju mos t'i ankohet njeri ALL-LLAHUT

për ty!"

www.myftinia-shkoder.org



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org